

DPSHTRR

Pyetësori teorik për CAP

Versioni 1.0

Viti 2015

Punuan: Ilir GJELISHTI

Gjon KOLA

Përmbajtje

KAPITULLI I	4
PAJISJA E PËRDORUESVE TË MJETEVE RRUGORE ME CERTIFIKATËN E AFTËSIMIT PROFESIONAL	4
I.1 Detyrimi i pajisjes së përdoruesve të mjeteve rrugore me Certifikatën e Aftësisë Profesionale për disa transporte specifike mallrash dhe udhëtarësh.....	4
I.2 Mjetet, drejtimi i të cilave kërkon pajisjen e përdoruesve me CAP, detyrimet, përjashtimet, vlefshmëria dhe rinovimi i CAP	4
KAPITULLI II	6
MJETET RRUGORE DHE DREJTIMI I TYRE	6
II.1 Mjetet rrugore dhe klasifikimi i tyre, automjetet dhe rimorkiot, karakteristikat konstruktive dhe funksionale të mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre dhe sistemet e pajimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, klasifikimi i mjeteve rrugore.....	6
II.2 Të dhëna për identifikimin e mjetit dhe gjendjen teknike të tij.....	11
II.3 Transporti i mallrave dhe i njerëzve me mjetet me motor dhe me rimorkio, masat administrative përkatëse	13
II.4 Drejtimi i mjeteve, normat e sjelljes, qarkullimi në rrugët urbane, interurbane dhe autostrada.....	14
KAPITULLI III	22
KLASIFIKIMI I MJETEVE RRUGORE, FORMALITETET PËR QARKULLIMIN E TYRE	22
III.1 Klasifikimi i mjeteve rrugore për efekt dallimi	22
III.2 Automjete dhe rimorkio për transport dhe përdorim të veçantë.....	24
III.3 Formalitetet për qarkullimin e mjeteve rrugore dhe mjetet jashtë norme dhe mjetet që përdoren për transporte në kushte jonormale.....	26
KAPITULLI IV	29
LLOJET E TRANSPORTIT	29
IV.1 Transporti i udhëtarëve, brenda dhe jashtë vendit. Llojet e transporteve dhe mjetet përkatëse.....	29
IV.2 Transporti i mallrave, brenda dhe jashtë vendit. Llojet e transporteve dhe mjetet përkatëse.....	34
IV.3 Dokumentet që kërkohen për kryerjen e transportit	36
KAPITULLI V	38
KOHA E PUNËS TË DREJTUESIT TË MJETIT, KOHA E PUSHIMIT. TAHOGRAFI	38
V.1 Kontrolli i kohës së punës të drejtuesit të mjetit	38
V.2 koha e pushimit	39

V.3 Tahografi.....	40
KAPITULLI VI.....	44
<i>NJOHURI TEKNIKO-PROFESIONALE TË DOMOSDOSHME PËR NIVELIN E KUALIFIKIMIT, PËR DREJTIMIN RACIONAL TË MJETIT ME MOTOR DHE RIMORKIOVE, PËR TË GARANTUAR SIGURI NË QARKULLIMIN RRUGOR DHE MBROJTJEN E MJEDISIT NGA NDOTJET.....</i>	44
VI.1 Njohja e karakteristikave të sistemit të transmetimit të lëvizjes	44
VI.2 Grafikët që kanë lidhje me momentin përdredhës, energjinë dhe konsumin specifik të një motori	45
VI.3 Njohja e karakteristikave dhe funksionimit të mjetit, minimizimi i prishjes dhe parandalimi i keqfunksionimit	46
VI.4 Veçori specifike të qarkut të frenave me presion hidraulik, kufijtë në përdorimin e frenave dhe ngadalësimin, përdorimi i mirë i shpejtësisë dhe i marsheve, përdorimi i inercisë së mjetit, mënyra e zvogëlimit të shpejtësisë dhe frenimi në rrugë zbritëse, veprimi në rast dështimit.	48
VI.5 Minimizimi i konsumit të karburantit	53
VI.6 Aftësia për të ngarkuar mjetin me kujdesin e duhur në përputhje me rregullat e sigurisë dhe përdorimin e duhur	55
VI.7 Forcat që ndikojnë mbi mjetet në lëvizje, përdorimi i raportit të shpejtësisë në përputhje me ngarkesën e mjetit dhe profilin e rrugës, përlllogaritja e ngarkesës së mjetit, përlllogaritja e volumit total, shpërndarja e ngarkesës, pasojat e mbingarkimit të boshtit, qëndrueshmëria e mjetit dhe qendra e gravitetit, tipet e paketimit dhe paletat.	57
IV.8 Aftësia për të siguruar rehatinë dhe sigurinë e pasagjerit: përshtatja e lëvizjeve gjatësore dhe anësore, ndarja e rrugës, pozicioni në rrugë, frenimi i butë, duke përdorur infrastruktura të veçanta (zonat publike, korsitë e dedikuara), menaxhimi i konflikteve mes drejtimit të mjetit në mënyrë të sigurt dhe roleve të tjera si një drejtues mjeti, duke ndërvepruar me pasagjerët, veçoritë e grupeve të caktuara të pasagjerëve (persona me aftësi të kufizuar, fëmijë).....	61
KAPITULLI VII.....	68
<i>APLIKIMI I RREGULLAVE</i>	68
VII.1 Njohja me rregullat që menaxhojnë transportin e mallrave: lejet e operimit në transport, detyrimet nën kontratat standarde për transportin e mallrave, hartimi i dokumenteve të cilat formojnë kontratën e transportit, lejet e transportit ndërkombëtar, detyrimet nën Konventën mbi kontratën për transportin ndërkombëtar të mallrave në rrugë, duke hartuar njoftimin e ngarkesës ndërkombëtare që kalon kufijtë, përcjelljen e ngarkesave të mallrave, dokumente të veçanta që shoqërojnë mallrat.....	68
VII.2 Njohja me rregullat që menaxhojnë transportin e pasagjerëve: transporti i grupeve specifike të pasagjerëve, pajisjet e sigurisë në autobusë, rripat e sigurisë, ngarkesa e mjetit.	82
KAPITULLI VIII.....	88
<i>SHËNDETI, SIGURIA NË RRUGË, MJEDISI EKONOMIK, SHËRBIMET DHE LOGJISTIKA</i>	88

VIII.1 Ndërgjegjësimi i drejtuesve të mjeteve ndaj rreziqeve të rrugës dhe aksidenteve në punë: tipat e aksidenteve në punë në sektorin e transportit, statistikat e aksidenteve në rrugë, përfshirja e kamionëve/veturave, njerëzve, pasojave materiale dhe financiare.	88
VIII.2 Aftësia për të parandaluar rreziqet fizike, lëvizje dhe qëndrime të cilat paraqesin rrezik, përshtatje fizike, trajtimi i ushtrimeve, mbrojtja personale	93
VIII.3 Informimi mbi rëndësinë e aftësive fizike dhe mendore: parimet e shëndetshme, të ushqyerit e balancuar, efektet e alkoolit, drogave dhe substancave të tjera të ngjashme që ndikojnë sjelljen, simptomat, shkaqet, efektet e lodhjes dhe stresit, roli themelor i punës bazë/fazës së pushimit	95
VIII.4 Vlerësimi i situatës së emergjencës: sjellja në një situatë emergjence: vlerësimi i situatës, që shmang ndërlikimet e një aksidenti, thirrja për ndihmë, ndihmesa e të dëmtuarve dhe dhënia e ndihmës së parë, reagimi në rast zjarri, evakuimi i pasagjerëve të një kamioni/autobusi, duke garantuar sigurinë e të gjithë pasagjerëve, reagimin në rast sulmi; parimet bazë për hartimin e një raport aksidenti.....	99
VIII.5 Aftësia për të përshtatur sjelljen në ndihmë të rritjes së imazhit të kompanisë: sjellja e drejtuesit të mjetit dhe imazhi i kompanisë: rëndësia e standardit të shërbimit siguruar nga drejtuesi i mjetit për kompaninë, rolet e drejtuesit të mjetit, njerëzit me të cilët ka të bëjë drejtuesi i mjetit, mirëmbajtja e mjetit, organizimi i punës, efektet komerciale dhe financiare të një diskutimi.	101
KAPITULLI IX.....	103
<i>NJOHURI TEKNIKO-PROFESIONALE PËR VEPRIMTARINË E RIPARIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PJESËVE MEKANIKE DHE TË MOTORIT TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE, PËR TË GARANTUAR SIGURI NË QARKULLIMIN RRUGOR DHE MBROJTJEN E MJEDISIT NGA NDOTJET</i>	103
IX.1 Motorët me djegie të brendshme, Llojet e motorëve me djegie të brendshme, ndërtimi, funksionimi, shërbimet teknike, defektet e mundshme dhe mundësia e riparimit të tyre.	103
IX.2 Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes	112
IX.3 Shasia, karrocëria, mekanizmi i drejtimit, i lëvizjes, i frenimit, gomat dhe suspensionet, llojet, ndërtimi,.....	118
IX.4 Sistemi Elektrik, i ndezjes, i ushqimit, llojet, ndërtimi, funksionimi, defektet dhe eliminimi i tyre.....	133
<i>Punuan:.....</i>	138
<i>Ilir GJELISHTI.....</i>	138
<i>Gjon KOLA.....</i>	138

KAPITULLI I
PAJISJA E PËRDORUESVE TË MJETEVE RRUGORE ME CERTIFIKATËN E
AFTËSIMIT PROFESIONAL

I.1 Detyrimi i pajisjes së përdoruesve të mjeteve rrugore me Certifikatën e Aftësisë Profesionale për disa transporte specifike mallrash dhe udhëtarësh

Pyetësoni 1	Certifikata e Aftësisimit Profesional
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. për transportin e mallrave, është e vlefshme për drejtimin e automjeteve të artikulluar, nëse përdoruesi i tyre është i pajisur me leje drejtimi të kategorisë CE 2. për transport udhëtarësh, është e vlefshme për drejtimin e automjeteve të destinuara për transportin e udhëtareve, që kanë më shumë se 8 ndenjësë, nëse përdoruesi i tyre është i pajisur me leje drejtimi të kategorisë D 3. për transport udhëtarësh, është e vlefshme për drejtimin e automjeteve të artikulluar, të destinuara për transportin e udhëtarëve, nëse përdoruesi i tyre është i pajisur me leje drejtimi të kategorisë DE
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. për transportin e mallrave, është e vlefshme për drejtimin e automjeteve të destinuara për transportin e udhëtarëve, që kanë më shumë se 8 ndenjësë, nëse përdoruesi i tyre është i pajisur me leje drejtimi të kategorisë D 2. për transportin e mallrave, është e vlefshme për drejtimin e automjeteve të artikulluar, nëse përdoruesi i tyre është i pajisur me leje drejtimi të kategorisë D 3. për transportin e mallrave, është e vlefshme për drejtimin e automjeteve të destinuara për transportin e udhëtarëve, që kanë më shumë se 8 ndenjësë, nëse përdoruesi i tyre është i pajisur me leje drejtimi të kategorisë D

I.2 Mjetet, drejtimi i të cilave kërkon pajisjen e përdoruesve me CAP, detyrimet, përjashtimet, vlefshmëria dhe rinovimi i CAP

Pyetësoni 2	Përjashtohen nga detyrimi për tu pajisur me Certifikatë të Aftësisimit Profesional, drejtuesit e mjeteve
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shpejtësia maksimale e autorizuar e të cilave, nuk i kalon 45 km/orë 2. të përdorura nga, ose nën kontrollin e forcave të armatosura 3. të mbrojtjes civile, shërbimeve kundra zjarrit dhe forcave përgjegjëse për ruajtjen e rendit publik 4. të përdorura në rastet e emergjencës ose të caktuara për misionet e shpëtimit 5. të përdorura në kursin e mësimin të drejtimit të mjetit për çdo person që ka dëshirë të marrë një leje drejtimi ose një CAP

	<ol style="list-style-type: none"> 6. të përdorura për transportin jo-komercial të pasagjerëve ose mallrave, për përdorim personal 7. që mbartin materiale ose pajisje për t'u përdorur nga drejtuesi i mjetit.
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. që punojnë për të tretë në transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve 2. që punojnë për të tretë në transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave 3. kur mjetet që drejtojnë janë të përdorura nga, ose nën kontrollin e, forcave të armatosura 4. kur mjetet që drejtojnë janë për nevoja emergjence ose të caktuara për misionet e shpëtimit 5. kur shpejtësia maksimale e autorizuar e të cilave nuk i kalon 45 km/orë

Pyetësori 3	Rinovimi i Certifikatës së Aftësisë Profesionale
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. bëhet vetëm pas skadimit të afatit të vlefshmërisë së sajë 2. bëhet pasi mbajtësi i sajë të jetë nënshtruar trajnimit periodik dhe të jetë shpallur fitues në testin teorik 3. bëhet pa ju nënshtruar një testimi praktik
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. bëhet pasi mbajtësi i sajë të jetë nënshtruar një testimi të detyrueshëm praktik për kategorinë më të madhe të ÇAP-it që zotëron 2. është i detyrueshëm të bëhet një herë në tre vjet për drejtuesit e mjeteve me moshë mbi 50 vjeç 3. bëhet pa ju nënshtruar një trajnimi periodik 4. bëhet edhe para skadimit të afatit të vlefshmërisë së sajë

Pyetësori 4	Afati i vlefshmërisë së Certifikatës së Aftësisë Profesionale
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është jo më i madh se 5 vjet nga data e lëshimit 2. është jo më i madh se afati i vlefshmërisë së kategorisë respektive të leje drejtimit të mbajtësit të sajë 3. varet edhe nga mosha e drejtuesit të mjetit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk varet nga mosha e drejtuesit të mjetit 2. është 10 vjet për drejtuesit që nuk kanë mbushur moshën 50 vjeç 3. në raste të veçanta mund të jetë më i madh se 5 vjet

Pyetësori 5	Certifikata e Aftësisë Profesionale
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është e vlefshme edhe për transportet jashtë vendit 2. është e vlefshme edhe për transportet brenda vendit 3. nuk është e vlefshme pa një lejedrejtimi të vlefshme të së njëjtës kategori
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk është e vlefshme për transportet brenda vendit 2. nuk është e vlefshme për transportet jashtë vendit

	3. i jep të drejtën mbajtësit të saj të drejtojë mjetin edhe kur nuk ka një leje drejtimi të vlefshme për drejtimin e atij mjeti
--	--

KAPITULLI II

MJETET RRUGORE DHE DREJTIMI I TYRE

II.1 Mjetet rrugore dhe klasifikimi i tyre, automjetet dhe rimorkiot, karakteristikat konstruktive dhe funksionale të mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre dhe sistemet e pajimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, klasifikimi i mjeteve rrugore

Pyetësoni 6	Bëjnë pjesë në automjete
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. autoveturat 2. autobusët 3. kamionët 4. tërheqësit 5. makinat e ngarkim-transportit 6. autokampet 7. artikularët 8. gjysme rimorkiatorët 9. autotrenat
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. trolejbusët 2. makinat teknologjike 3. autokarrot 4. mjetet rrugore të veçanta 5. rimorkiot 6. traktorët bujqësorë me goma pneumatike

Pyetësoni 7	Në bazë të kategorive ndërkombëtare, klasifikohen në
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. kategorinë M mjetet me motor të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë të paktën 4 rrota 2. kategorinë N mjetet me motor, me të paktën katër rrota të destinuara për transport mallrash 3. kategorinë O rimorkiot (përfshi edhe gjysme rimorkiot)
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. kategorinë M të gjitha mjetet me të paktën katër rrota 2. kategorinë N të mjetet e destinuara për transport udhëtarësh 3. kategorinë O vetëm rimorkiot me katër rrota

Pyetësoni 8	Në bazë të kategorive ndërkombëtare, klasifikohen në
--------------------	---

Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. kategorinë N1 mjetet me motor për transport mallrash me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3.5 tonë 2. kategorinë N2 automjetet për transport mallrash me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3.5 tonë, por jo më të madhe se 12 tonë 3. kategorinë N3 automjetet për transport mallrash me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. kategorinë N1 të gjitha mjetet me peshë maksimale deri në 3.5 tonë 2. kategorinë N të gjitha rimorkiot për transport malli 3. kategorinë N2 të gjitha rimorkiot me dy rrota deri në 3.5 tonë

Pyetësoni 9	Kamionët,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. janë mjete të destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar, për përpunimin ose transportin e këtyre mallrave 2. transportojnë mallra dhe njerëz të caktuar, për përpunimin ose transportin e këtyre mallrave 3. transportojnë edhe njerëz të caktuar, për përpunimin ose transportin e mallit që transportohet
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. janë vetëm për transportin e mallrave 2. janë vetëm për transport mallrash me peshë jo më të madhe se 12000 kg 3. janë vetëm për transport mallrash me peshë më të madhe se 3500kg

Pyetësoni 10	Automjetet për transport të përzier,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. kanë peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë deri në 4.5 tonë, kur kanë tërheqje elektrike me bateri 2. me motor me djegie të brendshme janë të destinuara për transport malli dhe njerëzish deri në nëntë persona, përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, me peshë të përgjithshme deri në 3.5 tonë 3. kanë peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë deri 3.5 tonë, kur kanë motor me djegie të brendshme
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. bëjnë pjesë në kategorinë e kamionëve 2. kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë mbi 5 tonë 3. nuk mund të transportojnë njerëz, përveç drejtuesit të tyre

Pyetësoni 11	Automjetet për transport të veçantë,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. janë të destinuar për transportin e disa mallrave dhe njerëzve të caktuar në kushte të veçanta 2. janë të pajisur në mënyrë të përhershme me mekanizma speciale që i shërbejnë qëllimit të transportit 3. përfshijnë edhe ato me cisterna për transportin e lëngjeve

Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk i përfshijnë automjetet me cisterna për transportin e lëngjeve 2. përfshijnë edhe autovinçat 3. përfshijnë edhe autoambulancat
----------------------	---

Pyetësoni 12	Automjetet për përdorim të veçantë,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. janë mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar për transportin e këtyre mekanizmave 2. janë mjete në të cilat lejohet transporti i personelit dhe materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të mekanizmave që transportojnë 3. përfshijnë edhe auto pompat që shërbejnë për hedhjen e betonit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. janë mjete të pajisura përkohësisht me mekanizma të veçantë 2. përfshijnë betonierët 3. nuk i përfshijnë autovinçat

Pyetësoni 13	Makinat e ngarkim-transportit,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. janë mjete ose komplekse mjetesh që kanë pajisje të veçanta për ngarkimin dhe transportin e materialeve që përdoren 2. janë mjete ose komplekse mjetesh që kanë pajisje të veçanta për ngarkimin dhe transportin e materialeve që janë produkt i punimeve të ndërtimit apo gërmimit 3. duhet të jenë të përshtatshme për t'u përdorur në kantiere ose për përdorim të përzier në rrugë dhe jashtë saj
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. bëjnë pjesë në kategorinë e kamionëve 2. bëjnë pjesë në kategorinë e motomjeteve 3. përdoren për transport udhëtarësh

Pyetësoni 14	Bëjnë pjesë në grupin e rimorkiove,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. rimorkiot ose gjysmërimorkiot, për transport pasagjerësh 2. rimorkiot për transport mallrash 3. rimorkiot për përdorim të veçantë 4. karrelat (mjete shtojcë që nuk kanë më shumë se dy rrota dhe që janë të destinuara, për transport bagazhi, pajisjesh, etj.) 5. gjysmërimorkiot (mjete të ndërtuara në mënyrë të tillë, që një pjesë e tyre ti mbivihet njësisë motorike dhe që një pjesë e konsiderueshme e ngarkesës së saj të mbahet nga kjo njësi) 6. rimorkiot për transport të pajisjeve turistike dhe sportive (me një ose me dy akse)
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. vetëm rimorkiot për transport të veçantë 2. vetëm rimorkiot kamp 3. makinat bujqësore teknologjike të tërhequra 4. makinat teknologjike që tërhiqen 5. gjysmërimorkiatorët 6. automjetet në avari, kur tërhiqen nga një automjet tjetër

Pyetësi 15	Në bazë të kategorive ndërkombëtare,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. klasifikohen në kategorinë O rimorkiot (ku përfshihen dhe gjysmërimorkiot) 2. klasifikohen në kategorinë O1 rimorkiot me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0.75 tonë 3. klasifikohen në kategorinë O2 rimorkiot me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0.75 tonë, por jo më të madhe se 3.5 tonë 4. klasifikohen në kategorinë O3 rimorkiot me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3.5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë 5. klasifikohen në kategorinë O4 rimorkiot me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. klasifikohen në kategorinë O2 rimorkiot me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0.75 tonë 2. klasifikohen në kategorinë O3 rimorkiot me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0.75 tonë, por jo më të madhe se 3.5 tonë 3. klasifikohen në kategorinë O4 rimorkiot me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3.5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë

Pyetësi 16	Rimorkiot për transport të veçantë kanë pajisje të përhershme me mekanizma specialë që i shërbejnë qëllimit të transportit, të cilat mund të jenë
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. rimorkio frigoriferë 2. rimorkio me karroceri të përshtatur për ngarkimin, përpunimin, transportimin e plehrave të forta të qyteteve 3. rimorkio cisterne për transportin e materialeve të shkrira apo në formë pluhuri 4. rimorkio me shasi të përshtatshme, për transportin e kontejnerëve apo të shtëpive të lëvizshme 5. rimorkio për transportin e personave në kushte të veçanta 6. rimorkio për transportin e mjeteve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. rimorkio që transportojnë sonda shpimi ose shkallë për ndërhyrje në lartësi 2. vetëm rimorkio cisterne, për transportin e ujerave të zeza 3. vetëm rimorkiot për transportin e mallrave të rrezikshme

Pyetësi 17	Rimorkiot për përdorim të veçantë, transportojnë përherë mekanizma të veçantë dhe mund të jenë,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. rimorkio të caktuara vetëm për tu shërbyer automjeteve, për përdorim të veçantë 2. rimorkio të përshtatura, për transportin në rrugë të mjeteve hekurudhore 3. rimorkio me karroceri në përputhje me automjetin, për përdorim të

	veçantë, të cilit i është caktuar
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> vetëm rimorkiot me karroceri në përputhje me automjetin, për përdorim të veçantë çdo rimorkio që tërhiqet nga një mjet për përdorim të veçantë të pajisura me mekanizma për punime bujqësore

Pyetësoni 18	Treguesit konstruktivë(ndërtimorë) dhe funksionale të mjetit,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> janë të shënuar në lejen e qarkullimit mund të ndryshohen, nëse miratohen nga organet e DPSHTRR nëse nuk përputhen me lejen e qarkullimit, merret masa e heqjes së saj
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> nuk janë të shënuar në lejen e qarkullimit kur ndryshohen, nuk është e nevojshme të ndryshohet leja e qarkullimit nuk regjistrohen në zyrat e tatim taksave për të gjithë mjetet

Pyetësoni 19	Është tregues konstruktiv (ndërtimor) i automjeteve,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> fuqia e motorit tipi i transmisionit dhe raportet pesha e përgjithshme numri i akseve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> vetëm dimensionet e gomës që përdoren gjatësia dhe gjerësia e valixheve që mund të vendosen në mjet vetëm fuqia dhe cilindrat e motorit vetëm numri i cilindrave

Pyetësoni 20	Bën pjesë në sistemet e pajimit të automjeteve
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> sistemi i drejtimit sistemi i frenimit sistemi i sinjaleve pamore dhe ndriçuese sistemi i sinjalizimit zanor sistemi i shikimit prapa gomat mekanizmi i qëndrimit (frenat e dorës) sinjali i lëvizshëm i rrezikut treguesi kilometrik i dyllosur sinjali i lëvizshëm shume funksionesh për ndihmë sistemi i lëvizjes prapa kutia e ndihmës së shpejtë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> mekanizmi i mbrojtjes (bllokazhi), për mjetet me peshë nën 0.35 tonë sinjali i lëvizshëm i rrezikut, vetëm për ato me peshë nën 3.5 tonë treguesi kilometrik i dyllosur, vetëm për ato me peshë bosh mbi 3.5 tonë

Pyetësoni 21	Bën pjesë në sistemet e pajimit të rimorkiove
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. sistemi i frenimit 2. sistemi i sinjaleve pamore dhe ndriçuese 3. gomat
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. sistemi drejtimit 2. sistemi zhurmëmbytës 3. pasqyrat që shohin prapa

II.2 Të dhëna për identifikimin e mjetit dhe gjendjen teknike të tij

Pyetësoni 22	Tabela dhe numri i identifikimit të mjeteve,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërbejnë për identifikimin e ciklomotorëve, motomjeteve, automjeteve dhe rimorkiove 2. janë të vendosur në vende të dukshme mbi një pjesë të mjetit, që normalisht nuk zëvendësohet gjatë përdorimit të mjetit 3. nëse janë ndryshuar, falsifikuar, hequr, fshirë apo ndryshuar, kur nuk përbën vepër penale, ndaj drejtuesit merret masa administrative me gjobë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. lejohet të ndryshohen nga servisi, ku mjeti kryen shërbimet teknike 2. përdoret vetëm për automjetet 3. nuk përdoren për rimorkiot

Pyetësoni 23	Cilido që qarkullon me një mjet,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. i cili ka ndryshime në karakteristikat konstruktive të përcaktuar, ndëshkohet me gjobë dhe i bllokohet mjeti deri në plotësimin e kërkesave teknike e funksionale 2. të cilit i janë ndryshuar karakteristikat e treguara në certifikatën e homologimit dhe në lejen e qarkullimit, ndëshkohet me gjobë, si dhe merret masa plotësuese e heqjes së lejes së qarkullimit 3. të cilit i është modifikuar shasia dhe nuk ka marrë pëlqimin pas kontrollit të provës, ndëshkohet me gjobë, si dhe merret masa plotësuese e heqjes së lejes së qarkullimit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. i cili ka ndryshime në karakteristikat konstruktive të përcaktuar, ndëshkohet vetëm me gjobë 2. i cili ka ndryshime në karakteristikat konstruktive të përcaktuar, ndëshkohet me pezullim të lejes së drejtimit 3. i cili ka ndryshime në karakteristikat konstruktive të përcaktuar, ndëshkohet vetëm me heqje të lejes së qarkullimit

Pyetësoni 24	Certifikata e kontrollit teknik,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. tregon përmbushjen e kushteve teknike të mjetit, për të qarkulluar me të 2. i lëshohet të gjitha mjeteve rrugore me motor, pas kryerjes

	kontrollit teknik të tyre 3. ka të shënuara tregues konstruktivë (ndërtimorë) që janë në lejen e qarkullimit të mjetit
Përgjigje të gabuara	1. i lëshohet të gjitha mjeteve rrugore, edhe atyre pa motor 2. ka vlefshmëri dyvjeçare 3. është dokument që nuk është e nevojshme ta keni kur qarkulloni me mjet

Pyetësoni 25	Kontrolli teknik
Përgjigje të sakta	1. është detyrim ligjor për të gjitha llojet e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre 2. kryhet një herë në vit për të gjitha automjetet për përdorim vetjak 3. është i detyrueshëm edhe për mjetet e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve 4. për kategori dhe destinacione të ndryshme të mjeteve, nuk ka të njëjtin afat kohor 5. verifikon nëse mjetet garantojnë sigurinë në qarkullim, si dhe ndotja nuk i kalon kufijtë e caktuar ligjor 6. i mjetit rrugor quhet i përfunduar me lëshimin e certifikatës përkatëse
Përgjigje të gabuara	1. u kryhet vetëm mjeteve rrugore me motor 2. është i detyrueshëm vetëm për motomjetet 3. ka të njëjtin afat kohor për të gjitha mjetet rrugore 4. kryhet një herë në vit për të gjitha mjetet rrugore 5. kryhet çdo gjashtë muaj për të gjitha mjetet rrugore

Pyetësoni 26	Gjatë kontrollit teknik të automjeteve, bëhet verifikimi
Përgjigje të sakta	1. i përputhjes së treguesve konstruktive, me ato të shënuara në lejen e qarkullimit 2. i gjendjes së xhamave, fenerëve, stopave dhe pamjes së jashtme të automjetit 3. i thellësisë së kanaleve në lulet e gomave që nuk duhet të jenë më pak se 1.6 mm 4. i ndotjes, i cili nuk duhet të kalojë kufijtë e caktuar
Përgjigje të gabuara	1. vetëm i madhësisë së konsumimit të amortizatorëve, balestrave dhe ferrotave 2. vetëm i madhësisë së konsumimit të elementëve të sistemit të drejtimit 3. vetëm i gjendjes teknike të sistemit të frenimit

Pyetësoni 27	Cilido që qarkullon me mjet, të cilit nuk i është kryer kontrolli teknik
Përgjigje të sakta	1. në afat më pak se një muaj nga afati i parashikuar, ndëshkohet me gjobë dhe tërheqje e lejes së qarkullimit deri në kryerjen e

	<p>kontrollit teknik</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. në afat më shumë se një muaj nga afati i parashikuar, ndëshkohet me gjobë dhe tërheqje të lejes së qarkullimit deri në kryerjen e kontrollit teknik 3. por ka certifikatë kontrolli teknik false, nëse nuk përbën veprë penale, ndëshkohet me gjobë dhe tërheqje të leje qarkullimit të mjetit 4. brenda afateve të parashikuara, ndëshkohet me gjobë dhe tërheqje të lejes së qarkullimit deri në kryerjen e kontrollit teknik, nëse mjete përdoret për transportin e mallrave të rrezikshme
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. më shumë se një muaj nga afati i parashikuar, ndëshkohet vetëm me gjobë 2. me një afat deri një muaj, nuk ndëshkohet me masë administrative 3. me një afat mbi 10 ditë, nuk ndëshkohet me masë administrative

II.3 Transporti i mallrave dhe i njerëzve me mjetet me motor dhe me rimorkio, masat administrative përkatëse

Pyetësori 28	Gjatë transportit të mallrave ne mjetet me motor, ne rimorkio dhe ne makinat teknologjike
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk duhet të kalohet pesha e përgjithshme e shënuar në lejen e qarkullimit 2. kur pesha përgjithshme e mjetit me ngarkese është më e madhe se 5% e peshës së përgjithshme të shënuar në lejen e qarkullimit drejtuesi i mjetit ndëshkohet me gjobë 3. kur pesha përgjithshme e mjetit me ngarkese është më e madhe se 5% e peshës së përgjithshme të shënuar në lejen e qarkullimit pronari i mjetit ndëshkohet me gjobë 4. kur mbipesha është më e madhe se 10% e peshës së përgjithshme të shënuar në lejen e qarkullimit, krahas masës së gjobës, vazhdimi i lëvizjes kushtëzohet edhe me reduktimin e ngarkesës brenda kufijve të lejuar 5. si burim prove për kontrollin e peshës së ngarkesave shërbejnë pajisjet e organeve të kontrollit dhe dokumentet shoqëruese të mallit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. kur vërehet një mbipeshë më e madhe se 5% e peshës së përgjithshme me ngarkesë të plotë, vazhdimi i udhëtimit ndërpritet deri në reduktimin e ngarkesës brenda kufijve të lejuar 2. kur mbipesha është 10% e peshës së përgjithshme me ngarkesë të plotë, nuk aplikohet masë administrative 3. si burim prove për kontrollin e peshës së ngarkesave shërben deklarimi i drejtuesit të mjetit

Pyetësori 29	Mjetet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> teke ose me rimorkio me pajisje te veçanta te destinuar vetëm për transportin e mjeteve qe kalojnë përmasat gabarite kufitare, mund të qarkullojnë me ngarkesën e tyre vetëm në autostrada ose karregjate me korsi jo me te vogël se 6.5 metër me rimorkio ose gjysmerimorkio qe përdoren vetëm për transportin e kontejnerëve, qe i kalojnë përmasat gabarite kufitare, mund të qarkullojnë në rrugë me nënkalime kur hapësira mes mjetit dhe konstruksionit te nënkalimit nuk është me e vogël se 30 cm që transportojnë ngarkesa jashtë norme nuk duhet të kalojnë peshën e përgjithshme më shumë se 5% të peshës maksimale të përgjithshme të shënuar në autorizim
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> që transportojnë ngarkesa jashtë norme lejohet ta kalojnë peshën e përgjithshme deri në 20% të peshës maksimale të përgjithshme të shënuar në autorizim me rimorkio ose gjysmerimorkio qe përdoren vetëm për transportin e kontejnerëve, qe i kalojnë përmasat gabarite kufitare, mund të qarkullojnë në rrugë me nënkalime kur hapësira mes mjetit dhe konstruksionit te nënkalimit është 20 cm teke ose me rimorkio me pajisje te veçanta te destinuar vetëm për transportin e mjeteve qe kalojnë përmasat gabarite kufitare, mund të qarkullojnë me ngarkesën e tyre në rrugë me korsi me gjerësi 4.5 metër

II.4 Drejtimi i mjeteve, normat e sjelljes, qarkullimi në rrugët urbane, interurbane dhe autostrada

Pyetësori 30	Me lejedrejtimi të kategorisë C, lejohet të drejtohen
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> autovetura dhe motokarro automjete për transport malli me peshë të përgjithshme edhe mbi 3.5 tonë makina bujqësore dhe teknologjike jashtë norme, nëse jeni të pajisur dhe me Certifikatë të Aftësisë Profesionale (CAP) autokampe automjete për përdorim vetjak me 9 vende, përfshi dhe vendin e drejtuesit të mjetit automjete për transport të përzier mjete për të cilat kërkohet lejedrejtimi e kategorisë B
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> autovetura që tërheqin rimorkio me ngarkesë të plotë mbi 0.75 tonë automjete me 12+1 vende motorët me cilindratë deri në 350 cm³ automjete të shërbimit publik

	5. autovetura të shërbimit taksi
--	----------------------------------

Pyetësoni 31	Lejedrejtimi i kategorisë C,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> mund të merret vetëm nga ata drejtues, që kanë punuar 12 muaj me mjete që drejtohen me lejedrejtimi të kategorisë B dhe plotësojnë kushtet kur merret nga invalidë, duhet të ketë të pasqyruar dhe modifikimin që duhet të ketë mjete kur merret nga invalidët, ka të shënuar në të kufizimet për drejtimin e mjeteve të veçanta dhe me karakteristika të veçanta
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> mund të përdoret për autoveturat e shërbimit taksi mund të merret nga persona me moshë nën 18 vjeç mund të përdoret edhe nga persona me moshë mbi 65 vjeç

Pyetësoni 32	Një drejtues mjete i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë C dhe CAP (Certifikatë Aftësie Profesionale), lejohet të drejtojë:
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> automjete për përdorim të veçantë automjete për transport të veçantë ekskavatorë autokombajna të çfarëdo madhësie
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> autotrena mjete të shërbimit publik motora

Pyetësoni 33	Lejedrejtimi i kategorisë C
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> lëshohet nga degët e DPSHTRR është e vlefshme 5 vjet, për atë që në momentin e dhënies nuk ka kaluar moshën 50 vjeç është e vlefshme 3 vjet, për atë që në momentin e dhënies e ka kaluar moshën 60 vjeç
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> lëshohet edhe nga Autoriteti Rrugor Kombëtar është e vlefshme 3 vjet, për atë që në momentin e dhënies është nën 60 vjeç ka vlefshmëri 5 vjet, për ato që u janë dhënë personave me të meta fizike

Pyetësoni 34	Për tu pajisur me lejedrejtimi të kategorisë C, përgatitja praktike bëhet me automjete
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> teke me peshë të përgjithshme më të madhe se 12 tonë, gjatësi mbi 8 m dhe të realizojnë shpejtësi mbi 80 km/orë

	<ol style="list-style-type: none"> 2. që përveç plotësimit të kërkesave mbi peshën e gjatësinë, të jenë në gjendje të realizojnë shpejtësi mbi 80 km/orë 3. që përveç plotësimit të kërkesave të tjera, duhet të kenë edhe pedale komandimi të dyfishta 4. që përveç plotësimit të kërkesave të tjera, duhet të jenë të pajisura me pajisjen e regjistrimit të kohës dhe shpejtësisë (me tahograf)
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. teke me 3 akse, me peshë të përgjithshme më të vogël se 12 tonë 2. të llojit autotren 3. të llojit autobus

Pyetësori 35	Një drejtues mjete i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë C, mund të drejtojë
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. kamion që tërheq rimorkio me peshë të përgjithshme deri në 750 kg 2. makina bujqësore 3. makina teknologjike 4. çdo mjet që drejtohet me lejedrejtimi të kategorisë B
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. kamion që tërheq rimorkio me peshë të përgjithshme deri në 3.5 tonë 2. kamion që tërheq rimorkio me peshë të përgjithshme edhe mbi 750 kg 3. autotren

Pyetësori 36	Lejedrejtimi i përkohshëm i mjetit,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është i vlefshëm për 30 ditë 2. lëshohet në rastet e humbjes, vjedhjes ose shkatërrimit të lejedrejtimit dhe mbi bazën e vërtetimit të denoncimit të lëshuar nga organet e policisë 3. lëshohet nga organi që ka lëshuar lejedrejtimin
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. i lëshohet atij që ka filluar kursin për rritje kategorie të lejedrejtimit 2. i lëshohet atij që i është pezulluar lejedrejtimi nga organet e policisë rrugore 3. është i vlefshëm për 60 ditë

Pyetësori 37	Për të qarkulluar me një automjet, drejtuesi i mjetit, duhet të ketë me vete edhe
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. lejedrejtimi të vlefshme për kategorinë përkatëse të mjetit 2. certifikatën e formimit profesional (ADR), për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme 3. certifikatën e mjetit, kur mjeti është për përdorim nga të tretët
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. certifikatën e aftësisë profesionale, për të gjitha mjetet 2. lejen e transportit të mallrave, për përdorim vetjak 3. lejen e transportit të mallrave, kur mjeti është me peshëmbajtje

	deri në 1500 kg
--	-----------------

Pyetësori 38	Mjetet e një shteti të huaj
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. lejohet të qarkullojnë në Shqipëri deri një vit, kur kanë dokumentet e origjinës, leje qarkullimi ndërkombëtare, formalitetet doganore 2. që qarkullojnë në Shqipëri, duhet të jenë të pajisura nga ana e prapme edhe me shenjën dalluese të shtetit ku është regjistruar 3. kur drejtohen nga qytetarë që banojnë në Shqipëri, duhet të jenë të regjistruar pranë zyrave përkatëse
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. lejohet të hyjnë në Shqipëri ,nëse nuk janë të pajisur me dokumentet e origjinës dhe lejen ndërkombëtare të qarkullimit 2. lejohet të qarkullojnë në Shqipëri deri dy vjet, kur i kanë kryer formalitetet doganore 3. lejohet të hyjnë në Shqipëri, edhe kur nuk janë të pajisur me dokumentet e origjinës

Pyetësori 39	Një ndër kushtet që duhet plotësuar për drejtimin e mjeteve në Shqipëri me lejedrejtimi të lëshuara nga një shtet i huaj, është që
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. drejtuesi të jetë i pajisur me lejedrejtimi kombëtare të modelit të përcaktuar nga marrëveshje Ndërkombëtare ose me lejedrejtimi Ndërkombëtare 2. drejtuesit janë të detyruar të zbatojnë normat dhe rregullat e Kodit tonë Rrugor 3. nëse lejedrejtimi nuk është sipas marrëveshjeve Ndërkombëtare, ai duhet të shoqërohet nga një përkthim zyrtar në shqip 4. leja e drejtimit duhet të jetë e vlefshme, për kategorinë përkatëse të mjetit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. drejtuesi i mjetit të jetë banues më shumë se një vit në Shqipëri 2. drejtuesit janë të detyruar të zbatojnë normat dhe rregullat e vendit të tyre 3. lejedrejtimi të jetë i shoqëruar me kartën e identitetit

Pyetësori 40	Lejedrejtimi i lëshuar nga një shtet i huaj,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. mund të konvertohet në lejedrejtimi shqiptare, nëse është lëshuar nga një shtet anëtar i Komunitetit Evropian dhe nëse mbajtësi i saj është shtetas shqiptar 2. mund të konvertohet në lejedrejtimi shqiptare, nëse është lëshuar nga një shtet i KE dhe nëse mbajtësi i saj është shtetas i huaj, por që ka marrë leje banimi në Shqipëri 3. mund të konvertohet në lejedrejtimi shqiptare edhe nëse është lëshuar nga një shtet me të cilin ka një marrëveshje të tillë dhe

	<p>nëse mbajtësi i saj është shqiptar ose i huaj me leje banimi në Shqipëri</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. pas zëvendësimit me lejedrejtimi shqiptare, i rikthehet autoritetit të shtetit përkatës 5. zëvendësohet me lejedrejtimi shqiptare nga organet e DPSHTRR-së, pas plotësimit të kushteve të kërkuara
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. konvertohet në lejedrejtimi shqiptare ,vetëm nëse është lëshuar nga një shtet ballkanik 2. konvertohet në lejedrejtimi shqiptare edhe pa marrë lejen e banimit në Shqipëri 3. konvertohet në lejedrejtimi shqiptare, nëse është lëshuar nga SHBA 4. zëvendësohet me lejedrejtimi shqiptare nga organet e Policisë Rrugorë

Pyetësoni 41	Shpejtësia maksimale e lejuar e një kamioni me peshë të përgjithshme deri në 12 tonë, është
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. 90 km/orë në autostrada 2. 70 km/orë në rrugët interurbane kryesore 3. 35 km/orë në rrugët urbane
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. 80 km/orë në autostrada 2. 60 km/orë në rrugët interurbane dytësore 3. 40 km/orë në rrugët urbane

Pyetësoni 42	Shpejtësia maksimale e lejuar e një kamioni me peshë të përgjithshme më të madhe se 12 tonë, është
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. 80 km/orë në autostrada 2. 60 km/orë në rrugët interurbane dytësore 3. 60 km/orë në rrugët interurbane kryesore
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. 70 km/orë në rrugët interurbane kryesore 2. 40 km/orë në qendrat e banuara 3. 90 km/orë në autostrada

Pyetësoni 43	Shpejtësia maksimale e lejuar në rrugët interurbane dytësore, është
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. 50 km/orë për automjetet që transportojnë mallra të rrezikshme, të ngarkuar 2. 40 km/orë për makinat teknologjike me rrota gome 3. 60 km/orë për kamionët me peshë të përgjithshme më të madhe se 12 tonë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. 60 km/orë për makinat e ngarkim-transportit, kur janë pa ngarkesë 2. 40 km/orë për makinat bujqësore pa rrota gome 3. 90 km/orë për kamionët me peshë të përgjithshme nga 3.5 deri 12 tonë

Pyetësi 44	Në rregullimin e shpejtësisë, drejtuesi i kamionit, duhet të ketë parasysh
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. llojin e ngarkesës që transportohet (e ngurtë, e lëngët), si dhe sasinë e saj 2. karakteristikat dhe gjendjen e rrugës 3. kushtet atmosferike
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. vetëm fushëpamjen që ka 2. vetëm gjendjen e motorit 3. kohën, sepse duhet të arrihet sa më shpejt në destinacion

Pyetësi 45	Drejtuesi i kamionit, duhet të zvogëlojë shpejtësinë
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. kur në rrugë paraqitet një sinjal rreziku 2. deri në ndalim të plotë afër vendkalimeve të këmbësorëve 3. deri në ndalim të plotë, kur në rrugë lëvizin këmbësorë që shfaqin shenja hutimi 4. deri në ndalim të plotë, kur këmbësorët në rrugë vonojnë të largohen 5. në orët e natës si dhe në rastet e fushëpamjes së pamjaftueshme nga kushtet atmosferike ose shkaqe të tjera 6. në pjesë rrugë në të cilat janë derdhur baltë nga rrugët anësore
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. vetëm në rastet kur qarkullohet në asfalt të porsalagur nga shiu 2. vetëm në ato pjesë rrugë, në të cilat janë derdhur vajra lubrifikantë 3. vetëm në rastet kur rrugët janë të mbuluara nga dëborë e ngrirë ose nga akulli

Pyetësi 46	Largësia e sigurisë e një kamioni në lëvizje me mjetin që ka para,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. varet nga shpejtësia e lëvizjes së mjeteve 2. varet nga kushtet atmosferike 3. varet nga gjendja jo e rregullt teknike e sistemit të frenimit të mjetit 4. varet nga pjerrësia e rrugës 5. varet nga siguria e lidhjes së ngarkesës në mjetin që është para
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. varet nga cilindrata e motorit 2. varet vetëm nga aftësia profesionale e drejtuesit të mjetit 3. varet nga perimetri i gomave 4. varet nga lloji i kutisë së shpejtësisë së automjetit

Pyetësi 47	Gjatësia e rrugës së frenimit të automjetit (gjatësia e gjurmës frenimit)
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. varet nga shkalla e konsumimit të gomave 2. varet nga pjerrësia e rrugës 3. varet nga shpejtësia e lëvizjes

	<ol style="list-style-type: none"> 4. varet nga lloji i shtresës së sipërfaqes së rrugës 5. varet nga efektshmëria e sistemit të frenimit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. zvogëlohet, sa më të konsumuara të jenë gomat 2. zvogëlohet, nëse koeficienti i fërkimit midis rrugës dhe gomës është i vogël 3. është në varësi të rrugës që përshkon mjeti gjatë kohës së reagimit të drejtuesit 4. është e njëjte me distancën e sigurisë me mjetin para

Pyetësori 48	Gjatësia e rrugës së frenimit të një kamioni
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është në përpjesëtim të drejtë me katrorin e shpejtësisë së lëvizjes 2. rritet 9 herë, nëse shpejtësia trefishohet 3. rritet, nëse zvogëlohet koeficienti i fërkimit të gomave me rrugën
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. rritet 2 herë, nëse shpejtësia dyfishohet 2. është në përpjesëtim të drejtë me koeficientin e fërkimit 3. rritet, nëse zvogëlohet shpejtësia

Pyetësori 49	Gjatësia e rrugës së ndalimit të automjetit (rruga që përshkon mjeti gjatë kohës së reagimit dhe frenimit),
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është rruga e kryer nga mjeti nga çasti i perceptimit të rrezikut deri në ndalim 2. varet nga gjendja teknike e sistemit të frenimit 3. varet nga reflekset e drejtuesit të mjetit 4. varet nga shkalla e konsumimit të gomave 5. varet nga shpejtësia dhe gjendja e rrugës 6. përcaktohet edhe në varësi të pjerrësisë së rrugës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është e njëjte me gjatësinë e frenimit të mjetit 2. nuk varet nga kushtet atmosferike 3. zvogëlohet kur terreni është i rrëshqitshëm

Pyetësori 50	Në rast të zënies së karrexhatës, për shkak të rënies së ngarkesës nga mjeti, drejtuesi duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të lirojë sa më shpejt të jetë e mundur kalimin, për të mos penguar qarkullimin e mjeteve të tjera 2. të marrë masa, për të mënjanuar çdo rrezik për trafikun pasardhës 3. të sinjalizojë rrezikun ose pengesën nëpërmjet vendosjes së sinjalit të rrezikut
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mos e lëvizë ngarkesën, pa ardhur organet e policisë 2. të presë ardhjen e përfaqësuesit të entit pronar të rrugës, për zhvendosjen e ngarkesës 3. të presë ardhjen e punëtorëve të ngarkim-shkarkimit, për zhvendosjen e ngarkesës

Pyetësi 51	Në rastet e zënies së karrexhatës për shkaqe aksidentale të mjetit dhe kur sinjali i ndritshëm i rrezikut nuk funksionon, mjetet që vijnë pas duhet të sinjalizohen,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. me trekëndëshin e rrezikut, në rrugë interurbane dhe autostrada 2. me trekëndëshin e rrezikut që vendoset të paktën 100 metra pas mjetit, në rrugët interurbane kryesore 3. me mënyra të tjera të efektshme në mungesë të trekëndëshit të rrezikut
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. me trekëndëshin e rrezikut të vendosur prapa mjetit, sidomos kur jemi në kthesë 2. me trekëndëshin e rrezikut që vendoset të paktën 50 metra pas mjetit, kur jemi në rrugë interurbane dytësore dhe mjeti nuk duket 3. me trekëndëshin e rrezikut që vendoset të paktën 50 metra pas mjetit, kur jemi në autostrada

Pyetësi 52	Drejtuesit e automjeteve duhet të aktivizojnë sinjalizimin e ndritshëm të rrezikut (ndeja e të katër sinjaleve njëkohësisht),
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. në raste ndalimi emergjent që përbën rrezik për përdoruesit e tjerë të rrugës 2. në rast të zënies së karrexhatës, për shkak të ndonjë defekti në mjet 3. kur detyrohen të lëvizin me shpejtësi të ulët, për shkak të ndonjë defekti në mjet 4. në rast të qëndrimit të emergjencës, për gjendje të keqe shëndetësore të tyre 5. gjatë kohës që ndalojnë, për të vendosur apo rimarrë trekëndëshin e rrezikut
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. kur mjeti që është pas nesh nuk ruan distancën e sigurisë 2. kur lëvizet në rreshta paralele jashtë qendrave të banuara 3. kur është kohë me mjegull 4. kur bie shi

Pyetësi 53	Ndalohet qarkullimi në rrugët interurbane kryesore dhe në autostrada,
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. instalimi i sistemit të frenimit ABS për mjetet e kategorive N2, N3 2. instalimi i sistemit të frenimit ABS për të gjithë mjetet, pavarësisht nga viti i prodhimit 3. kufizuesi i shpejtësisë për mjetet e kategorive N2 dhe N3, pavarësisht nga viti i prodhimit të tyre

VII.2 Njohja me rregullat që menaxhojnë transportin e pasagjerëve: transporti i grupeve specifike të pasagjerëve, pajisjet e sigurisë në autobusë, rripat e sigurisë, ngarkesa e mjetit.

Pyetësoni 234	Marrëdhënia kontraktore, në transportin rrugor të udhëtarëve
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. përfundon, kur udhëtari zbret nga mjeti i transportit dhe janë kryer të gjitha veprimet e dorëzimit të çdo bagazhi që ai ka 2. përfundon atëherë, kur nuk ka më asnjë marrëdhënie materiale ndërmjet udhëtarit dhe mjetit 3. sjell përgjegjësi civile për ndërmarrjen e transportit 4. sjell përgjegjësi kontraktore për shkak të shkeljes së një detyrimi kontraktor
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. përfundon, kur udhëtari zbret nga mjeti i transportit 2. është e kufizuar, vetëm gjatë udhëtimit 3. sjell përgjegjësi civile, vetëm për drejtuesin e mjetit 4. përgjegjësia kontraktore nuk shtrihet në subjektet që përfshihen në kryerjen e transportit

Pyetësoni 235	Bileta e udhëtimit
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. ka edhe kundërbiletën fiskale 2. identifikon ndërmarrjen e transportit 3. mund të shitet nga transportuesi ose agjencia e kontraktuar prej tij 4. duhet të ketë të shënuar çmimin 5. duhet të ketë të shënuar periudhën e vlefshmërisë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk është e besueshme, nëse nuk janë shkruar kushtet e përgjithshme të transportit, në të 2. ka vlerë, deri në momentin që niset autobusi 3. duhet të ketë edhe kohëzgjatjen e udhëtimit 4. duhet të ketë të shënuar edhe targën e mjetit

Pyetësoni 236	Ne kontratën e transportit rrugor të udhëtarëve,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. objekt është transportimi i një apo disa personave nga një vend në një tjetër 2. subjekte janë udhëtari dhe ndërmarrja e transportit 3. si rregull, kontrata lidhet me dhënien e një biletë udhëtimi, kundrejt pagesës së një tarife të caktuar
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. subjekt i kontratës është vetëm udhëtari 2. prova e identitetit nuk ekziston 3. bileta e udhëtimit nuk shërben për të provuar ligjërisht, të drejtën e zotëruesit të saj lidhur me performancën e transportuesit

Pyetësoni 237	Agjencia e transportit të udhëtarëve
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është person fizik ose juridik

	<ol style="list-style-type: none"> 2. i shërben udhëtarëve dhe bagazheve, në nisjen e udhëtimit me autobus dhe në kthim 3. i shërben udhëtarëve dhe bagazheve duke organizuar udhëtimin me autobus 4. pajis udhëtarët me dokumentet e udhëtimit dhe organizon udhëtimin dhe shërbime të tjera, që lidhen me transportin
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk i shërben udhëtarëve, në kthim 2. ka detyrime vetëm për destinacionin, por jo për orarin e mbërritjes 3. nuk u jep udhëtarëve informacione që lidhen me transportin

Pyetësori 238	Për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve autobusi duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të plotësoje kriteret e komoditetit sipas akteve nënligjore në fuqi 2. të ketë edhe certifikatën e kontrollit teknik 3. të ketë edhe akt-vlerësimin e plotësimit të kushteve të komoditetit për transport udhëtarësh
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të ketë një vjetërsi prodhimi jo më shumë se 15 vjet 2. të ketë një vjetërsi prodhimi jo më shumë se 20 vjet 3. mjafton që të plotësojë kushtet e komoditetit për udhëtarët, por pa pasur ndonjë dokument

Pyetësori 239	Transportuesit që kryejnë veprimtari transporti në, nga dhe nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë janë të detyruar
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të përdorin mjete që e kanë kaluar kontrollin e nevojshëm teknik 2. të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrimet e nevojshme dhe dokumentet për çdo mjet 3. të ruajnë dokumentet e transportit deri në pesë vjet nga data e transportimit 4. të plotësoje evidenca statistikore sipas formateve të miratuara nga organet përkatëse dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të përdorin vetëm mjete të cilat kanë kryer kontrollin teknik, por pa dokumentet e transportit 2. të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrime e dokumente vetëm për mjetet pa kontroll teknik 3. që në çdo mjet të kenë vetëm dokumentacionin e qarkullimit në përputhje me “Kodin Rrugor” 4. nuk kanë detyrime që lidhen me numrin e mjeteve

Pyetësori 240	Rrjeti i linjave të transportit të udhëtarëve dhe oraret e tyre
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. miratohen me urdhër të Ministrit për linjat ndërqytetëse ndërmjet qarqeve të ndryshme 2. miratohen nga këshilli i qarkut për linjat rrethqytetëse 3. miratohen nga këshilli i qarkut për linjat ndërqytetëse brenda një qarku

	4. në të gjitha rastet miratohet nga organet e autorizuar me ligj
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> miratohen nga këshilli i qarkut për linjat qytetëse miratohen nga këshilli i qarkut për linjat ndërqytetëse midis qarqeve përcaktohen me urdhër të Ministrit për linjat rrethqytetëse përcaktohet me marrëveshje midis shoqërive të transportit, para fillimit të punës

Pyetësori 241	Këshilli i qarkut
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> miraton rrjetin e linjave rrethqytetëse miraton rrjetin e linjave ndërqytetëse brenda qarkut miraton oraret e linjave ndërqytetëse brenda qarkut përcakton dhe miraton edhe numrin e linjave përkatëse
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> miraton rrjetin e linjave qytetëse miraton oraret e linjave qytetëse përcakton edhe numrin e autobusëve për bashkitë në territorin e vet miraton edhe rrjetin e linjave urbane të qyteteve në varësi

Pyetësori 242	Ministri që mbulon veprimtarinë e transportit rrugor
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> miraton me urdhër rrjetin e linjave ndërqytetëse ndërmjet qarqeve miraton me urdhër rrjetin e linjave të bashkisë jo qendër rrethi me qendër rrethi të qarqeve të ndryshme miraton oraret e linjave ndërqytetëse ndërmjet qarqeve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> miraton rrjetin e linjave rrethqytetëse miraton oraret e linjave rrethqytetëse miraton edhe numrin e autobusëve për bashkitë në territorin e vet

Pyetësori 243	Leja e transportit (Autorizimi, leja bilaterale)
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> është një dokument që jep të drejtën për transport ndërkombëtar për një numër të pakufizuar udhëtimesh në linjë të rregullt udhëtarësh është një dokument që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtën e transportit ndërkombëtar për një periudhë kohe të caktuar është një dokument që të jep të drejtën e transportit ndërkombëtar edhe për të kryer një ose disa udhëtime vajtje–ardhje udhëtarësh është një dokument që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtën e kryerjes edhe të transportit ndërkombëtar të mallrave
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> shërben për të kryer vetëm transport udhëtarësh në linjë të rregullt jashtë territorit të Shqipërisë shërben për të kryer transport udhëtarësh për nevojat e veta jashtë territorit të Shqipërisë është një dokument që u jep të drejtën operatorëve të huaj për të kryer transport ndërkombëtar udhëtarësh është dokument që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtën e transportit ndërkombëtar për një periudhë kohe të pa caktuar

Pyetësi 244	Leja e operimit (Autorizimi) është një dokument që
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. u jep të drejtën operatorëve të huaj për të kryer transport ndërkombëtar udhëtarësh brenda territorit të Shqipërisë 2. u jep të drejtën e transportit operatorëve të huaj në Shqipëri për një periudhë të caktuar kohe dhe numër të pakufizuar udhëtimesh 3. u jep të drejtën e transportit operatorëve të huaj në Shqipëri edhe për një pjesë të udhëtimit të tyre 4. rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. jep të drejtën për transport ndërkombëtar për një numër të kufizuar udhëtimesh 2. të jep të drejtën e transportit ndërkombëtar për një periudhë kohe të pacaktuar 3. u jep të drejtën e transportit operatorëve të huaj vetëm për një udhëtim 4. nuk rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare

Pyetësi 245	Autoriteti kompetent që jep licencën për transport brenda vendit është
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bashkia ku ka selinë subjekti, për transportin ndërqytetës të udhëtarëve, brenda një qarku 2. Bashkia për agjenci transporti udhëtarësh dhe shërbim taksi 3. Bashkia, për transportin ndërqytetës të udhëtarëve, ndërmjet bashkive qendër të rretheve të ndryshme 4. Bashkia ku ka selinë subjekti, për transportin ndërqytetës të udhëtarëve, ndërmjet qarqeve të ndryshme
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. MTI- për transportin ndërqytetës brenda një qarku 2. Kryetari i bashkisë për shërbimet e rastit 3. Kryetari i qarkut për agjenci transporti udhëtarësh dhe shërbim taksi

Pyetësi 246	Për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve jepen nga MTI-ja
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. licencë për transport udhëtarësh 2. licencë edhe për agjenci transporti udhëtarësh 3. autorizim për shërbimet në linjë të rregullt
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i Bashkisë për gjithë transportin rethqytetës 2. Kryetari i qarkut për subjektet me seli në njesitë administrative nën juridiksionin e tij 3. Kryetari i këshillit bashkiak për transportin qytetës

Pyetësi 247	Për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve jepen nga MTI-ja
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. autorizim për shërbimet e rregullta të specializuara 2. autorizim për shërbimet vajtje ardhje 3. autorizim dhe libër udhëtimi për shërbimet e rastit

Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. MTI-ja për transportin ndërqtetës brenda një qarku 2. Kryetari i bashkisë për shërbimet e rastit 3. Kryetari i qarkut për agjenci transporti udhëtarësh dhe shërbim taksi
----------------------	--

Pyetësi 248	Marrëveshja Interbus
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një marrëveshje ndërkombëtare shumëpalëshe që rregullon shërbimet e rastit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe shteteve të tjera, jashtë BE 2. Marrëveshja Interbus rregullon shërbimet e rastit ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë 3. Marrëveshjes Interbus rregullon shërbimet e rastit ndërmjet Italisë dhe Turqisë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është një marrëveshje bilaterale ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, e cila rregullon të gjitha shërbimet e transportit të udhëtarëve 2. është një marrëveshje ndërkombëtare shumëpalëshe që rregullon shërbimet e rastit ndërmjet shteteve të Bashkimit Evropian 3. rregullon shërbimet e rastit në mes të Italisë dhe Zvicrës

Pyetësi 249	Fletët e udhëtimit INTERBUS
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. duhet të ndodhen në bordin e autobusit gjatë gjithë udhëtimit 2. duhet të përmbajnë listën e udhëtarëve 3. gjatë udhëtimit nëpër vendet e treta, duhet të shoqërohen me autorizimet përkatëse të tranzitit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. kur nuk ekzistojnë, përdoren fletët e udhëtimit CEE 2. që përdoren për një transport të rastit brenda shteteve të BE duhet të përmbajë listën e udhëtarëve 3. janë gjithsej 30 fletë dhe mbahen gjithnjë në bord

Pyetësi 250	Rregullat e qarkullimit
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. në Shqipëri, përgjithësisht, janë si ato të një pjesë të mirë të shteteve që janë pjesë e OKB 2. në Shqipëri, nuk janë në kundërshtim me ato të shteteve që kanë aderuar në konventat e Vjenës 3. në Angli detyrojnë mbajtjen e krahut të majtë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. në Francë detyrojnë mbajtjen e krahut të majtë 2. në Holandë detyrojnë mbajtjen e krahut të majtë 3. në Gjermani detyrojnë mbajtjen e krahut të majtë

Pyetësi 251	Rripat e sigurisë
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. janë instrumente pasivë të mbrojtjes 2. dhe sistemet e frenimit shërbejnë për të zvogëluar rrezikun e lëndimit të rëndë dhe me vdekje

	<ol style="list-style-type: none"> 3. dhe sistemet e frenimit i nënshtrohen kontrollit periodik 4. janë të pajisura edhe me pjesët përkatëse të rregullimit 5. duhet të jenë të një tipi të miratuar
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. janë instrumente të mbrojtjes aktive 2. nuk janë të dobishme, në rast të përmbysjes së automjetit 3. janë të nevojshme, vetëm për autobusët në shërbimin e linjës 4. nuk duhet të përdoren në autobusët e regjistruar për palët e treta

Pyetësoni 252	Detyrimi për të përdorur rripat e sigurisë, përveç në rastet e përjashtimit,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. mbulon drejtuesin dhe udhëtarët e mjeteve të cilat janë të pajisura me këto rripa 2. shërben për të minimizuar lëndimet e shkaktuara nga aksidentet e trafikut 3. shërben edhe për të minimizuar lëndimet e shkaktuara nga aksidentet që ndodhin në mjetet që lëvizin shpejtësi të ulët
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. mbulon vetëm udhëtarët e autobusëve të cilat janë të pajisura me këto rripa 2. mbulon vetëm drejtuesin, sepse udhëtarët përjashtohen, me rregull 3. zbatohet vetëm për udhëtarët, sepse drejtuesi përjashtohet si rregull

Pyetësoni 253	Janë të përjashtuar nga detyrimi për të përdorur rripat e sigurisë
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. instruktoret e praktikës, në ushtrimin e funksionit të tyre (madje edhe gjatë provimit të praktikës) 2. udhëtarët që udhëtojnë në zonat urbane me autobusë të kategorive M2 dhe M3, në të cilët lejohet transporti i njerëzve në këmbë 3. personat që vuajnë nga sëmundje të veçanta, për të cilat përdorimi i rripave është i dëmshëm 4. forcat e rendit gjatë kryerjes së shërbimeve emergjente 5. njerëz me sëmundje të veçanta të pajisur me vërtetimin mjekësor përkatës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. gratë shtatzëna, madje edhe pa vërtetim mjekësor që vërteton rrezikun e përdorimit të rripit 2. njerëzit mbipeshë 3. të moshuarit 4. gjithmonë, punëtorët e shërbimit, urgjencës mjekësore dhe zjarrit

KAPITULLI VIII
SHËNDETI, SIGURIA NË RRUGË, MJEDISI EKONOMIK, SHËRBIMET DHE
LOGJISTIKA

VIII.1 Ndërgjegjësimi i drejtuesve të mjeteve ndaj rreziqeve të rrugës dhe aksidenteve në punë: tipat e aksidenteve në punë në sektorin e transportit, statistikat e aksidenteve në rrugë, përfshirja e kamionëve/veturave, njerëzve, pasojave materiale dhe financiare.

Pyetësi 254	Mund të jetë shkak rreziku, gjatë udhëtimit
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shpejtësia e automjeteve dhe hapësira e ndalimit të tyre në kushte emergjence 2. kushtet atmosferike si ngrica, shiu, bora, mjegulla 3. një kthesë, një kryqëzim, një kurriz në rrugë 4. mosrespektimi i rregullave të qarkullimit nga kalimtarët apo drejtuesit e tjerë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. mosha e drejtuesit 2. gjatësia e drejtuesit 3. tipi i automjetit 4. kushtet kontraktore të drejtuesit

Pyetësi 255	Situatat e rrezikut
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. jo gjithnjë, mund të evitohen me anë të përdorimit të pajisjeve të sigurisë 2. duhet të parashikohen nga drejtuesi, me qëllim mbrojtjen e sigurisë së njerëzve 3. mund të shmangen nga reagimi i shpejtë i drejtuesit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. duhet të evitohen, duke mos kryer manovrime të rrezikshme 2. mund të evitohen, gjithnjë 3. nuk shkaktohen kurrë, nga gjendja fizike e drejtuesit 4. shmangen, duke u sjellur në mënyra të rrezikshme

Pyetësi 256	Për vlerësimin e saktë të rrezikut, gjatë udhëtimit, është e rëndësishme,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. përvoja e drejtuesit 2. shkalla e përqendrimit të drejtuesit 3. shpejtësia e reagimit të drejtuesit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. kategoria e lejes së drejtimit të drejtuesit 2. niveli i shërbimit të ndërmarrjes së transportit të drejtuesit 3. niveli i parkut të mjeteve të ndërmarrjes së transportit të drejtuesit marrëdhëniet e drejtuesit me kolegët

Pyetësi 257	Aksident në punë është
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. fraktura e drejtuesit të mjetit, e shkaktuar gjatë ngjitjes apo zbritjes në kabinën e mjetit në veprimtarinë e punës 2. lëndimi fizik që verifikohet gjatë mirëmbajtjes së automjetit

	<ol style="list-style-type: none"> 3. lëndimi i drejtuesit të mjetit gjatë veprimeve të ngarkim shkarkimit 4. lëndimi i drejtuesit të mjetit, i cili nuk respekton rregullat e sigurisë, që punëdhënësi ja ka bërë të ditura atij 5. lëndimi i drejtuesit të mjetit, i cili nuk përdor për neglizhence, pajisjet mbrojtëse individuale të cilat ja ka dhënë punëdhënësi
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. dëmtimi mallit që transportohet, në një automjet 2. aksidentimi i një turisti në bordin e një autobusi, gjatë transportit 3. çdo dëmtim organik ose funksional i drejtuesit të mjetit që shkaktohet gjatë veprimtarisë së përditshme të tij

Pyetësori 258	Aksident në punë është
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. çdo dëmtim i drejtuesit si rezultat i rrëzimit aksidental nga dyshemeja e ngarkesës së kamionit 2. dëmtimi i sistemit muskolor eshtëror gjatë operacioni të zëvendësimit të një gome 3. plagosja me sy e shaktuar nga kontakti aksidental me material gërryes që transportohet gjatë punës 4. çdo aksident që përfshin drejtuesin profesionist, i ndodhur brenda në garazh, në fund të turnit të punës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. çdo dëmtim i drejtuesit në rast të mosrespektimit të rregullave të sigurisë, që i janë komunikuar atij, nga punëdhënësi 2. pirja e tepruar e alkoolit gjatë periudhave të pushimit 3. aksidentimi i shoferëve vetëm, kur ato ndodhin gjatë lëvizjes me automjet

Pyetësori 259	Aksidentet rrugore ndodhin edhe për shkak të
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. drejtimit jo korrekt të automjetit nga drejtuesi i mjetit 2. shpejtësisë së papërshtatshme 3. mosrespektimit të rregullave të përparësisë 4. lodhjes së drejtuesi i mjetit 5. mosrespektimit të distancës së sigurisë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. mosfunktionimit të amortizatorëve 2. dëmtimit të tahogرافit 3. dëmtimit të pompës së ujit

Pyetësori 260	Drejtuesit e automjeteve duhet të aktivizojnë sinjalizimin e ndritshëm të rrezikut
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. në rast të qëndrimit në emergjencë për ndonjë defekt të mjetit 2. në rast të zënies së karrexhatës 3. kur jemi të detyruar të lëvizim me shpejtësi të ulët, për shkak të ndonjë defekti në mjet 4. në rast të qëndrimit të emergjencës për gjendje të keqe shëndetësore të drejtuesit të mjetit 5. gjatë kohës që ndalojnë për të vendosur apo rimarrë trekëndëshin e

	rrezikut
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. kur mjeti që është pas nesh nuk ruan distancën e sigurisë 2. natën, kur nuk funksionojnë dritat e pozicionit 3. kur lëvizet në rreshta paralele jashtë qendrave të banuara 4. kur është kohë me mjegull

Pyetëtori 261	Në rast të zënies së karrexhatës për shkak të derdhjes së ngarkesës, drejtuesi duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të lirojë rrugën sa më shpejt të jetë e mundur për të mundësuar kalimin e mjeteve 2. të marrë masa për çbllokimin e rrugës, duke e shtyrë mjetin jashtë karrexhatës 3. të sinjalizojë për rrezikun ose pengesën, nëpërmjet vendosjes së sinjalit të rrezikut 4. të informojë edhe entin pronar të rrugës, ose organet e policisë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të lirojë kur të ketë mundësi kalimin e mjeteve 2. të mos e lëvizë mjetin pa ardhur organet e policisë 3. të vendosë vetëm sinjalin e lëvizshëm të rrezikut në pozicionin e dhënë

Pyetëtori 262	Në rastet e zënies së karrexhatës për shkaqe aksidentale, mjetet që vijnë pas, duhet të sinjalizohen me trekëndëshin e rrezikut
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. për sa kohë që në karrexhatë ka mallra të rëna në asfalt 2. të paktën, 100m pas automjetit në rrugët interurbane kryesore, në rast se kemi bllokuar qarkullimin 3. të paktën, 100m pas automjetit në autostrada, në rast se kemi bllokuar qarkullimin
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. menjëherë, sidomos kur jemi në kthesë 2. vetëm në rast se kemi bllokuar qarkullimin 3. të paktën 50m pas automjetit, kur jemi në rrugë interurbane kryesore 4. të paktën 50m pas automjetit, kur jemi në autostrada

Pyetëtori 263	Drejtuesi i mjetit është i detyruar
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të vlerësojë çdo situatë emergjence që mund t'i çfaqet gjatë udhëtimit 2. të dijë të sillet në një situatë emergjence 3. të thërrasë apo të kërkojë ndihmë nga organet kompetente në rast avarije apo aksidenti, gjatë udhëtimit 4. të njohë parimet bazë dhe të hartojë në çdo rast një raport aksidenti 5. të japë ndihmën e parë, në rast aksidenti 6. t'i udhëzojë pasagjerët për daljet e emergjencës dhe të mundësojë evakuimin e tyre për çdo eventualitet të rrezikshëm

Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. vetëm, të japë ndihmën e parë në rast aksidenti 2. që në rast aksidenti, vetëm të shmangë ndërlikimin e situatave 3. të largojë menjëherë mjetin nga vendi i ngjarjes për mos bllokimin e trafikut
----------------------	---

Pyetësori 264	Për të evituar stresin në një situatë emergjence, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të vendosni emocionet tuaja nën kontroll, para se të filloni të veproni 2. të qëndroni fillimisht larg situatës, që të fitoni sigurinë e nevojshme 3. të mos nxitoni të veproni, që të mos vendosni edhe veten tuaj në rrezik
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të veproni energjikisht, pa e analizuar situatën, pasi nuk keni kohë 2. pavarësisht emocioneve, duhet të ndërhyni për të dhënë ndihmën e parë 3. të vini emocionet në kontroll dhe të prisni personat e specializuar për ndërhyrje 4. të filloni të jepni ndihmën, pa marrë parasysh rreziqet që ju kanosen

Pyetësori 265	Në rast aksidenti rrugor, drejtuesit e mjeteve të përfshira duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të përpiqen të ruajnë qetësinë 2. të konstatojnë dëmet pasi të kenë liruar rrugën 3. të raportojnë të gjitha informacionet e nevojshme, për rindërtimin e dinamikës së ngjarjes 4. vetëm të presin duke sinjalizuar për rrezikun, nëse nuk mund të lirohet karrexhata nga automjeti i aksidentuar
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mos zbresin nga automjeti, derisa të mbërrijë Policia 2. të mos zbresin nga automjeti, deri sa mbërrijë karrotreci 3. të presin patjetër një agjent policie, për plotësimin e formularit të konstatimit të aksidentit

Pyetësori 266	Në rast aksidenti rrugor, drejtuesi i mjetit
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. nëse ka të plagosur, është e nevojshme që të kërkojë ndërhyrjen e organeve të Policisë Rrugore për konstatimet që duhen kryer 2. duhet të mbajë shënim gjeneralitet e drejtuesit tjetër dhe të dhënat e lejes së drejtimit, automjetit dhe policës së sigurimit 3. duhet të nxjerrë të gjithë elementet e dobishme për rindërtimin e dinamikës së saktë të aksidentit 4. për denoncimin tek shoqëria siguroese mund të përdorë formularin e konstatimit miqësor të ngjarjes
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nëse ka të plagosur, në çdo rast duhet të thërrisë ndihmën e shpejtë 2. nëse është në faj, duhet të marrë gjeneralitet e drejtuesit tjetër; nëse ka të drejtë, nuk është e nevojshme 3. mjafton që të kujtohet për pozicionin e saktë të automjeteve pas përplasjes 4. nëse ndërhyt autoriteti policor, duhet vetëm të ngulë këmbë që të

	shkruhet versioni i tij për aksidentin
--	--

Pyetësori 267	Në rastin e një aksidenti rrugor, drejtuesi i mjetit duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të kujdeset, së pari për sigurinë e tij 2. të verifikojë, nëse ka tym apo zjarr në mjetet e përfshira 3. ta mbrojë një të plagosur, që nuk mund të spostohet nga karrexhata 4. t'u sinjalizojë rrezikun, automjeteve që mbërrijnë 5. t'u japë ndihmë të lënduarve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. t'i kërkojë ndihmë e përfaqësuesit ligjor, para çdo veprimi tjetër 2. t'u japë alkool të lënduarve, kur është e nevojshme 3. të mjaftohet, duke sinjalizuar rrezikun me bori

Pyetësori 268	Në rastet e aksidenteve rrugore,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk duhet të spostohen të lënduarit që nuk janë në gjendje të lëvizin, në rast se ata nuk janë në një rrezik të menjëhershëm 2. duhet ndaluar për të ndihmuar të aksidentuarin, duke e qetësuar dhe siguruar atë 3. duhet të pritët personeli i ndihmës së shpejtë për të spostuar të lënduarit, nëse ata nuk janë në gjendjen e një rreziku të menjëhershëm 4. nuk duhet t'u jepen pije, të lënduarve që janë në gjendje të pandërgjegjshme
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. duhet të njoftohet ambulanca, edhe nëse nuk ka të lënduar 2. ku ka vetëm dëme materiale, duhet të njoftohet policia rrugore 3. duhet t'i jepen gjeneralitetet drejtuesit të mjetit tjetër të përfshirë, vetëm në prani të forcave të rendit 4. duhet të lëvizet menjëherë i aksidentuari, pavarësisht nga lëndimet e pësuar

Pyetësori 269	Të ndihmosh një të dëmtuar në rrugë
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është e detyrueshme edhe si detyrë morale 2. është e detyrueshme, sepse Kodi Penal e dënon mosdhënien e ndihmës 3. është e detyrueshme, sepse kështu mund të kufizohen pasojat negative të aksidentit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk është e detyrueshme 2. është e detyrueshme vetëm nëse gjykohet si aksident i rëndë 3. nuk është veprim i detyrueshëm (për të shmangur përfshirjen në ngjarje) 4. është i detyrueshëm vetëm për mjekët dhe personelin sanitar

VIII.2 Aftësia për të parandaluar rreziqet fizike, lëvizje dhe qëndrime të cilat paraqesin rrezik, përshtatje fizike, trajtimi i ushtrimeve, mbrojtja personale

Pyetësori 270	Nëse viktimi e një aksidenti rrugor paraqet një plagë me gjak, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mbulohet plaga me material të pastër dhe të shtrëngohet, për të bllokuar rrjedhjen e gjakut 2. të lahet me ujë nëse plaga është ndotur me dhera 3. të mos lëvizet trupa të huaj të mundshëm të pranishëm 4. të bllokohet rrjedhja e gjakut me garzë sterile ose me copë të pastër
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të nxirren menjëherë trupat e huaj të pranishëm në plagë, pastaj të mbulohet 2. t'i jepet për të pirë ujë ose çaj nëse është pa ndjenja 3. të mos mbulohet plaga për të lehtësuar mpiksjen spontane të gjakut 4. të manipulohet plaga në mënyrë që të zvogëlohet dalja e gjakut

Pyetësori 271	Në rast të një hemorragjie të jashtme, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të bllokohet dhe të lidhet plaga si dhe të thirret menjëherë ndihma 2. të lidhet menjëherë plaga, mundësisht me material të pastër 3. të ndalohet rrjedhja e gjakut 4. të mbahet i dëmtuari në pozicion ulur ose shtrirë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mbulohet plaga 2. të mbulohet plaga dhe të bësh që të ecë i dëmtuari, për të shmangur shfaqjen e gjendjes së shokut 3. të ndalohet absolutisht që i dëmtuari të pijë ujë

Pyetësori 272	Nëse i dëmtuari ka një trup të huaj në një sy, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të lidhet syri pa e nxjerrë trupin e huaj 2. të ndalohet që i dëmtuari të prekë syrin e plagosur, për të shmangur dëmtime më të rënda 3. të lidhet syri dhe të ndalohet që të preket deri në ndërhyrjen e një specialisti
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të bëhet përpjekje për të nxjerrë trupin e huaj për të shmangur infeksionet 2. t'i ndalohet të dëmtuarit të mbyllë syrin, për të evituar dëmtime të tjera 3. të masazhohet ngadalë syri për të favorizuar lotimin 4. të mos lidhet syri absolutisht

Pyetësori 273	Shenjat e fillimit të gjendjes së shokut janë
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. lëkurë e ftohtë me ngjyrë shumë të zbehtë 2. djersë të ftohta në ballë dhe gjendje e tensionuar 3. të dridhura, lëkurë shumë e zbehtë dhe djersë të ftohta në ballë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. shfaqja e lëvizjeve të pakoordinuara të gjymtyrëve

	<ol style="list-style-type: none"> 2. thënia e frazave dhe fjalëve pa kuptim 3. shfaqja e ngjyrës së kuqe të lëkurës, që tregon rritje të temperaturës
--	--

Pyetësi 274	Kur i dëmtuari paraqet gjendje shoku duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të shtrihet në tokë, të mbulohet dhe, të mbahen të ngritura gjymtyrët e poshtme 2. të mbulohet sa më mirë të jetë e mundur 3. të shtrihet me gjymtyrët e poshtme të ngritura nga trupi
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të ngrihet për të ecur që të riaktivizohet qarkullimi i gjakut 2. të vendoset në pozicion ulur 3. të goditet me kujdes në fytyrë dhe gjymtyrë për të riaktivizuar qarkullimin e gjakut 4. t'i jepen sasi të vogla pije alkoolike

Pyetësi 275	Nëse viktima e një aksidenti rrugor është pa ndjenja, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të shihet nëse merr frymë duke i vënë dorën në pjesën anësore të poshtme të gjoksit, ose mbi bark 2. nëse merr frymë vetë, të vendoset në pozicionin anësor të sigurisë 3. nëse nuk merr frymë, t'i lirohet goja edhe hunda nga pengesa të mundshme 4. të kujdesesh për gjendjen e tij deri në mbërritjen e ambulancës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të bësh të ecë e të flasësh me të dëmtuarin, për ta mbajtur zgjuar 2. të fashojsh dhe të të bësh që të mos mundet të lëvizë kokën 3. të pyetet nëse ka dhembje në kokë

Pyetësi 276	Në rast se i dëmtuari, i vetëdijshëm, ka një traumë në kafazin e kraharorit, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. t'i lehtësohet frymëmarrja duke e vendosur të dëmtuarin gjysmëulur 2. në rast të plagës së dukshme dhe të thellë, të shtypet menjëherë me një copë të pastër 3. të ruhet me kujdes deri në mbërritjen e ndihmës parë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. ta ndihmosh të bëjë frymëmarrje të thella 2. të vendoset i plagosuri në pozicion shtrirë 3. në rast plage të thellë, të pastrohet, dezinfektohet dhe të mjekohet plaga 4. të vendoset i dëmtuari në pozicion drejt për të kufizuar daljen e gjakut

Pyetësi 277	Në rast se i dëmtuari paraqet një ose më shumë fraktura në gjymtyrë, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mos lëvizet gjymtyra e thyer para se të jetë bërë e palëvizshme 2. të bëhet e palëvizshme me mjete të rastit gjymtyra e thyer, pa vazhduar me manovra të tjera

	<ol style="list-style-type: none"> 3. të mbulohen me material të pastër plagët e mundshme të shkaktuara nga thyerjet 4. pasi të bëhet e palëvizshme gjymtyra të merren masat parandaluese kundër gjendjes së shokut nëse është e mundshme dhe e nevojshme
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të përpiqesh të rregullosh thyerjen për të pakësuar dhimbjet 2. të nxitet i dëmtuari të lëvizë gjymtyrën e thyer për të vlerësuar dëmtimet 3. në rast të thyerjes së kockës dhe kocka ka dalë jashtë, të përpiqesh ta rivendosësh përsëri në pozicionin e saj normal 4. t'i jepet të plagosurit një pije e fortë alkoolike

VIII.3 Informimi mbi rëndësinë e aftësive fizike dhe mendore: parimet e shëndetshme, të ushqyerit e balancuar, efektet e alkoolit, drogave dhe substancave të tjera të ngjashme që ndikojnë sjelljen, simptomat, shkaqet, efektet e lodhjes dhe stresit, roli themelor i punës bazë/fazës së pushimit

Pyetësori 278	Drejtuesi i mjetit duhet të ndërgjegjësohet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. për trajtimin ushqimor si domosdoshmëri e sigurimit të një fiziku normal dhe të aftë për përballimin e udhëtimit, nga ana e tij 2. për domosdoshmërinë e një ushqimi të balancuar 3. edhe për efektet negative të përdorimit të alkoolit, drogave dhe substancave të tjera të ngjashme me to, në drejtimin e mjetit 4. për rolin kryesor të punës dhe pushimit të detyrueshëm
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. për trajtimin ushqimor të pasagjerëve për përballimin e udhëtimit 2. në veçanti, për efektet negative të përdorimit gjatë udhëtimit të alkoolit dhe drogave nga pasagjerët 3. në mënyrë të veçantë, për të shfrytëzuar në maksimum mjetin duke hipur në të, brenda kapaciteve të lejuar, çdo udhëtar që ja kërkon këtë jashtë agjencive

Pyetësori 279	Ushqimi i duhur i drejtuesit të mjetit
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. përbëhet nga ushqime lehtësisht të asimilueshme 2. përbëhet nga ushqime të lehta dhe energjitike 3. parashikon konsumin e ujit, frutave, perimeve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. parashikon konsumin e ushqimeve të fërguara dhe të pasura me yndyrë 2. konsiston, në ngrënie e sasive të larta të mishit të kuq 3. gjatë udhëtimit, të konsumojë një sasi të madhe kafeje për të larguar gjumin

Pyetësori 280	Drejtuesit e mjeteve duhet të dine se
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. disa medikamente shkaktajnë marramendje 2. disa medikamente mund të kenë efekte anësore që ndikojnë negativisht ngarjen e mjetit

	<ol style="list-style-type: none"> 3. disa medikamente shkaktojnë uljen e përqendrimit 4. marrja e medikamenteve apo, qetësuesve, nuk duhet të shoqërohet me alkool për rritjen e efektit qetësues të tyre 5. marrja e njëkohshme e medikamenteve dhe alkoolit mund të shkaktojë pasoja negative gjatë udhëtimit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është rregull i mirë për një shofer që të pijë një sasi alkooli, për të favorizuar tretjen e ushqimit, gjatë udhëtimit 2. është rregull i mirë për një drejtues që të pijë një sasi të vogël verë të kuqe gjatë udhëtimit 3. është rregull i mirë për një drejtues që të shmangë pirjen e ujit gjatë udhëtimit 4. medikamentet shkaktojnë efekte anësore vetëm kur i marrin me stomak bosh 5. nëse e kalon kohën e punës të përcaktuar në legjislacion, mund të marrë qetësues për të vazhduar udhëtimin

Pyetësori 281	Drejtuesit e mjeteve duhet të dine se
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. marrja e ekstazisë mund të rezultojë, fillimisht, me një gjendje euforie 2. marrja e ekstazisë mund të çojë në vjellje, takikardi dhe konfuzion 3. marrja e ekstazisë mund të çojë në humbjen e memories 4. marrja e ekstazisë zgjat kohën e reagimit 5. përdorimi i drogës është i ndaluar gjithmonë për drejtuesit profesionistë 6. përdorimi i drogës mund të çojë në pushimin nga puna të drejtuesve profesionistë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. marrja e ekstazisë lejohet vetëm për të tejkaluar kohën punës të përcaktuar në legjislacion 2. marrja e ekstazisë lejohet vetëm në qoftë se ju jeni në një udhëtim të lodhshëm 3. marijuana është një ilaç për të kuruar dhimbjen e kokës 4. marijuana shkurton kohën e reagimit 5. marrja e marijuanës nuk është e sanksionuar nga Kodi Rrugor

Pyetësori 282	Drejtuesit e mjeteve duhet të dinë se
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. cilat janë kërkesat fizike dhe psikologjike të nevojshme për ngarjen e mjetit 2. duhet të ndalojnë udhëtimin, kur ndiejnë se janë të lodhur 3. duhet të ndalojnë udhëtimin, kur ndiejnë se janë në një gjendje të fortë emocionale 4. duhet të ndalojnë udhëtimin, kur ndiejnë se janë të sëmurë 5. duhet të ndalojnë udhëtimin, kur kanë marrë ilaçe që mund të kompromentojnë aftësinë e tyre të drejtimit 6. duhet të mos udhëtojnë pasi ata kanë ngrënë ushqime shumë të

	rënda për t'u tretur
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. përdorimi i drogës mund të lejohet ndonjëherë për drejtuesit profesionistë 2. përdorimi i drogës mund të lejohet vetëm për drejtuesit e transportit të mallrave por jo për ata të udhëtarëve 3. mund të udhëtojnë në distanca të shkurtra në kushte të rënda fizike, në qoftë se në fund të udhëtimit kanë një pushim shtesë 4. stresi psikologjik nuk ka ndikim negativ në ngarjen e mjetit 5. “goditja” e gjumit ndodh vetëm gjatë natës

Pyetësori 283	Përdorimi i alkoolit nga drejtuesi i mjetit ndikon në drejtimin e mjetit, për shkak se
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. mund të çojë në eufori, pakujdesi dhe e bën më pak të sigurt drejtimin e mjetit 2. i bën më të ngadalta reflekset e drejtuesit të mjetit 3. mund të shkaktojë gjendjen e gjumit tek drejtuesi i mjetit 4. ndryshon aftësitë e përqendrimit dhe të vëmendjes, në drejtimin e mjetit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. e bën më të sigurt, sepse largon lodhjen e drejtuesit të mjetit 2. rrit aftësinë e përqendrimit dhe e lehtëson drejtimin e mjetit 3. të bën më vigjilent dhe të kujdesshëm 4. përmirëson aftësinë pamore dhe shpejtësinë e reagimit të drejtuesit

Pyetësori 284	Nëse drejtuesi i një autobusi konstaton, se në bord ka njerëz të dyshimtë, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të njoftojë sa në shpejtë të jetë e mundur dhe pa rënë në sy, organet përkatëse 2. të mos çfaqë interes dhe të mos hyjë në konflikt me ta 3. të mos bjerë pre e provokimeve dhe të vazhdojë të drejtojë i qetë mjetin 4. që në pamundësi të njoftimit gjatë udhëtimit, ta bëjë atë pa rënë në sy menjëherë, sapo të ketë mbërritur në destinacionin më të afërt
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. t'i urdhërojë ata, të zbresin nga mjete 2. t'i neutralizojë ata fizikisht dhe t'i dorëzojë në organet përkatëse 3. që, duke u kërkuar ndihmë udhëtarëve të tjerë, t'i izolojë ata dhe t'i çojë në komisariatit më të afërt të policisë 4. të mos nisë udhëtimin, pa ardhur më parë organet kompetente për sqarimin e situatës

Pyetësori 285	Nëse drejtuesi i mjetit konstaton se në bord janë futur lëndë narkotike për t'u transportuar, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. pa u vënë re, të krijojë mundësinë për njoftimin e organeve kompetente

	<ol style="list-style-type: none"> 2. të mbajë në lartësinë e duhur moralin e tij, të pasagjerëve dhe, të mos bjerë në sy deri në destinacionin më të afërt dhe të informojë organet kompetente 3. të preokupohet për situatën dhe përpiqet për t'i dhënë rrugë zgjidhje asaj
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mos e nisë mjetin, pa zbritur poseduesi i lëndëve narkotike. 2. t'i kërkojë poseduesit që të dorëzojë më parë lëndët narkotike dhe pastaj, të fillojë udhëtimin 3. të bëjë bllokimin e mjetit dhe të udhëtarëve dhe të njoftojë menjëherë, organet kompetente. 4. të vazhdojë udhëtimin deri në destinacionin e fundit, pa u shqetësuar, sepse nuk është pjesë e detyrës së tij

Pyetësoni 286	Stresi psikofizik i drejtuesit profesionist të mjetit
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shkaktohet nga kryerja e aktivitetit të punës, gjatë kohës së pushimit të detyruar 2. shkaktohet nga ndryshimi i vazhdueshëm i orareve të ngrënies dhe të gjumit 3. shkaktohet nga zhurma e jashtëzakonshme e ambientit 4. shkakton tension muskular që ndikon në posturën e drejtuesit të mjetit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. shkaktohet nga përdorimi i ajrit të kondicionuar, gjatë udhëtimit 2. shkaktohet nga fjetja tetë orë pandërprere 3. e ul mundësinë e aksidenteve rrugore

Pyetësoni 287	Stresi psikofizik dhe lodhja e drejtuesit të mjetit, gjatë udhëtimit,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. i shkakton atij, rritjen e kohës së reagimit 2. i shkakton atij, uljen e përqendrimit 3. është një faktor rreziku për sigurinë rrugore
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. kompensohet, kur mjeti është i pajisur me ABS, pasi kjo përmirëson kohët e reagimit të tij 2. i lejon atij që ta vazhdojë udhëtimin, vetëm pasi të pijë një kafe të fortë 3. shkakton rritjen e mprehtësisë së shikimit të tij 4. e detyron atë të hapë dritaren

Pyetësoni 288	Drejtuesi i mjetit i cili shfaq shenja lodhje duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të arrijë në vendpushimin më të afërt dhe të pushojë 2. të ulë shpejtësinë dhe të qëndrojë në vendpushimin e parë që t'i shfaqet 3. nëse është e nevojshme, mund të përdorë për pushim edhe korsinë e emergjencës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të nxitojë dhe të shtojë shpejtësinë, që të mbërrijë sa më shpejt në destinacionin për ku është nisur

	<ol style="list-style-type: none"> 2. t'i qëndrojë sa më afër automjetit që ka përpara 3. të fikë dritat e kruskotit
--	--

Pyetësori 289	Ndihmon në parandalimin e sëmundjeve profesionale
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. respektimi i kohëve të udhëtimit sipas rregullave të kërkuara nga legjislacioni 2. respektimi i pushimeve gjatë udhëtimit sipas rregullave të kërkuara nga legjislacioni 3. minimizimi i orëve të udhëtimit natën 4. përputhja sa më shumë të jetë e mundur e rrëgjimit të zakonshëm gjumë-zgjim e drejtuesit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. udhëtimi në mënyrë të vazhdueshme për të paktën gjashtë orë, para mbërritjes në destinacionin 2. rritja e konsumit të cigareve 3. dëgjimi i radios me zë të lartë 4. ekspozimi i vazhdueshëm ndaj dridhjeve 5. kushtet e ngarjes në trafikun e tepruar

Pyetësori 290	Gjatë aktivitetit profesional
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. drejtuesi është i ekspozuar ndaj lëndim 2. nga ndotja mjedisore 3. drejtuesi është i ekspozuar ndaj të gjitha sëmundjeve të sistemit muskulo-eshtror për shkak të posturës së parregullt
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. lëndimet e shkaktuara nga rrëzimi i ngarkesës nuk përfshihen në rreziqet profesionale të drejtuesit 2. pajisjet personale mbrojtëse nuk janë mjete për sigurimin e shëndetit të drejtuesve 3. gjendja e filtrave të ajrit nuk ndikon në cilësinë e ajrit në kabinë

VIII.4 Vlerësimi i situatës së emergjencës: sjellja në një situatë emergjence: vlerësimi i situatës, që shmang ndërlikimet e një aksidenti, thirrja për ndihmë, ndihmesa e të dëmtuarve dhe dhënia e ndihmës së parë, reagimi në rast zjarri, evakuimi i pasagjerëve të një kamioni/autobusi, duke garantuar sigurinë e të gjithë pasagjerëve, reagimin në rast sulmi; parimet bazë për hartimin e një raport aksidenti.

Pyetësori 291	Në rast aksidenti, ai që jep ndihmën duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të vlerësojë situatën, me qëllim që të mbrojë të dëmtuarin nga rreziqe të tjera 2. të ndihmojë të dëmtuarin sa më mirë që të mundet, pa ndërmarrë iniciativa që i takojnë organeve kompetente mjekësore 3. të sinjalizojë sa më mirë zonën e aksidentit 4. të kryejë veprime të ndihmës sipas mundësive dhe njohjeve të veta
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të largohet nga vendi i aksidentit 2. të distancohet dhe të presë ndihmë pa bërë asgjë

	<ol style="list-style-type: none"> 3. të identifikojë të dëmtuarin 4. t'i japë medikamente të dëmtuarit, edhe pa pasur kompetencën e duhur
--	--

Pyetësori 292	Për të evituar stresin në një situatë emergjence, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të vendosni emocionet tuaja nën kontroll, para se të filloni të veproni 2. të qëndroni fillimisht larg situatës, që të fitoni sigurinë e nevojshme 3. të mos nxitoni të veproni, që të mos vendosni edhe veten tuaj në rrezik
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të veproni energjikisht, pa e analizuar situatën, pasi nuk keni kohë 2. pavarësisht emocioneve, duhet të ndërhyjni për të dhënë ndihmën e parë 3. të vini emocionet në kontroll dhe të prisni personat e specializuar për ndërhyrje 4. të filloni të jepni ndihmën, pa marrë parasysh rreziqet që ju kanosen

Pyetësori 293	Në rast aksidenti rrugor, drejtuesit e mjeteve të përfshira duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të përpiqen të ruajnë qetësinë 2. të konstatojnë dëmet pasi të kenë liruar rrugën 3. të raportojnë të gjitha informacionet e nevojshme, për rindërtimin e dinamikës së ngjarjes 4. vetëm të presin duke sinjalizuar për rrezikun, nëse nuk mund të lirohet karrexhata nga automjeti i aksidentuar
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të mos zbresin nga automjeti, derisa të mbërrijë Policia 2. të mos zbresin nga automjeti, deri sa mbërrijë karrotreci 3. të presin patjetër një agjent policie, për plotësimin e formularit të konstatimit të aksidentit

Pyetësori 294	Në rast aksidenti, ai që i jep ndihmën e parë një të lënduari duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të përcaktojë menjëherë, nëse ai merr frymë dhe zemra i rreh 2. të përcaktojë menjëherë, nëse ai reagon ndaj stimujve verbale 3. të përcaktojë menjëherë, nëse ai i ka të gjitha funksionet jetësore kryesore 4. të telefonojë menjëherë, në numrat e ambulancës së ndihmës së shpejtë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të ndërhyjë menjëherë, për spostimin e tij 2. t'i mbulojë atij fytyrën me një copë të pastër 3. të përcaktojë menjëherë, nëse ai e mban mend targën e mjetit të tij

Pyetësori 295	Për të shmangur infeksionet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është e rëndësishme të ruheni në maksimum, nëpërmjet eliminimit të kontakteve direkte me të aksidentuarin 2. është e nevojshme larja e duarve me ujë dhe sapun para edhe pas

	<p>dhënies së ndihmës së parë</p> <ol style="list-style-type: none"> nëse është e mundur duhen përdorur doreza, në pamundësi qeska të pastra plastike për izolimin e duarve dhe ruajtjen e tyre është e nevojshme të tregohet kujdes kur preken objekte të mprehta të cilat duhen sistemuar në vende të parrezikshme
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> duhet të shmangim çdo kontakt me të aksidentuarin duhet që detyrimisht të përdorim doreza dhe, në pamundësi, nuk duhet të ndërhyjmë për ti dhënë ndihmë të aksidentuarit duhet të mos preket me dorë i aksidentuari

Pyetësori 296	Në rast se si pasojë e një aksidenti rrugor, ka pasur zjarr dhe viktima paraqet djegie, duhet
përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> të shuhen flakët me batanije ose materiale të tjera të ngjashme të mos hiqen mbetjet e mundshme të veshjeve të ngjitura në pjesët e djegura nëse djegia i përket gjymtyrëve, kur është e mundur të futen ato në ujë të ftohtë për të lehtësuar dhimbjen nëse djegiet përfshijnë trupin, të mbulohen me material, mundësisht steril (të pastër)
përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> nëse ka akoma mbetje të flakëve, të pritët që të shuhen pastaj të ndërhyhet të hiqen gjithë mbeturinat e veshjeve të djegura në pjesët e dëmtuara të dezinfektohen djegiet me alkool

VIII.5 Aftësia për të përshtatur sjelljen në ndihmë të rritjes së imazhit të kompanisë: sjellja e drejtuesit të mjetit dhe imazhi i kompanisë: rëndësia e standardit të shërbimit siguruar nga drejtuesi i mjetit për kompaninë, rolet e drejtuesit të mjetit, njerëzit me të cilët ka të bëjë drejtuesi i mjetit, mirëmbajtja e mjetit, organizimi i punës, efektet komerciale dhe financiare të një diskutimi.

Pyetësori 297	Imazhi i një ndërmarrjeje transporti
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> përcaktohet, edhe nga gjykimet e punëmarrësve kushtëzon mendimet e klientëve ndikon në të ardhurat e saj përfaqësohet nga opinionet dhe vizioni që klientët kanë për të varet edhe nga cilësia e performancës së punës e drejtuesve të mjeteve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> varet nga numri i mjeteve në dispozicion të ndërmarrjes nuk varet nga puna e drejtuesve të mjeteve përcaktohet nga tipi i kontratës kolektive dhe asaj individuale që zbatohet me punëmarrësit

Pyetësori 298	Imazhi i një ndërmarrjeje transporti
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. ndikohet edhe nga mënyra e bashkëveprimit të drejtuesve të mjeteve me udhëtarët 2. ndikohet edhe nga mbajtja e pastërtisë së mjeteve të transportit 3. përcaktohet edhe nga cilësia e shërbimit 4. përcaktohet nga përmirësimi i vazhdueshëm dhe rinovimi i shërbimit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. përcaktohet nga mosha e drejtuesve të mjeteve 2. formohet vetëm nga fushatat publicitare 3. formohet nga tipi i mallrave që transportohen

Pyetësori 299	Imazhi i një ndërmarrjeje transporti
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. përcaktohet edhe nga mënyra e sjelljes së drejtuesve të mjeteve që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me klientët 2. përcaktohet nga modernizimi i mjeteve të transportit 3. përcaktohet nga ndjeshmëria ekologjike dhe kujdesi për mbrojtjen e mjedisit 4. varet edhe nga mënyra e sjelljes së drejtuesve të mjeteve me drejtuesit e kompanisë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk varet nga sjellja e drejtuesve të mjeteve 2. nuk ka rëndësi, pasi është një sektor që nuk është subjekt i konkurrencës 3. kushtëzohet edhe nga fakti, se drejtuesit e mjeteve pijnë duhan

Pyetësori 300	Drejtuesi i mjetit i një ndërmarrjeje transporti ka një rol të rëndësishëm, pasi ai
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. ka kontakte me shumë klientë 2. ka kontakte me spedicionerë dhe agjentë udhëtimi 3. ka kontakte me autoritete doganore
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. ka kontakte me autoritetet që kanë dhënë autorizimet, për kryerjen e shërbimit 2. ka kontakte me shumë bankierë 3. mban edhe bilancin e ndërmarrjes

Pyetësori 301	Drejtuesi i mjetit i një ndërmarrjeje transporti duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të kuptojë se kur, ka nevojë për specialistë të kualifikuar për riparimin e defektit në mjetin e tij 2. të informojë menjëherë në ndërmarrje për defektet e ndryshme në mjet 3. të njohë shumë mirë funksionimin e instrumenteve në kruskot 4. të njohë mirë kuptimin e llambave spi elektrike 5. të dijë të konsultohet me manualin e përdorimit dhe mirëmbajtjes të mjetit

Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> të dijë të vendosë në fazë motorin diesel të çmontojë tahografin dixhital, kur ka defekt të parashikojë vetë, riparimin dhe zëvendësimin e pjesëve të konsumuara të frenave
----------------------	---

Pyetëtori 302	Drejtuesi i mjetit i një ndërmarrjeje transporti, për të kontribuar në cilësinë e shërbimit, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> të vendosë marrëdhënie miqësore dhe respekti me klientët të punojë në mënyrë që të garantojë sigurinë maksimale të përmbushë detyrimet kontraktuale, duke pasur parasysh rregullat e ndërmarrjes të dijë, nëse është kryer kolaudimi i kartës së tahografit të mjetit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> të firmosë lejen e qarkullimit, pas kryerjes së kolaudimit të mjetit të njohë të paktën dy gjuhë të bëjë policën e sigurimit të jetës

Pyetëtori 303	Drejtuesi i mjetit i një ndërmarrjeje transporti, kur nuk është pronar, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> të jetë i kujdesshëm të jetë i bindur të jetë i besuar të bashkëpunojë me kolegët të vishet në mënyrë etike dhe profesionale
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> të investojë lekët brenda ndërmarrjes të përcaktojë koston e shërbimit të sigurojë polica sigurimi sa më të leverdishme

KAPITULLI IX

NJOHURI TEKNIKO-PROFESIONALE PËR VEPRIMTARINË E RIPARIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PJESËVE MEKANIKE DHE TË MOTORIT TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE, PËR TË GARANTUAR SIGURI NË QARKULLIMIN RRUGOR DHE MBROJTJEN E MJEDISIT NGA NDOTJET

IX.1 Motorët me djegie të brendshme, Llojet e motorëve me djegie të brendshme, ndërtimi, funksionimi, shërbimet teknike, defektet e mundshme dhe mundësia e riparimit të tyre.

Pyetëtori 304	Motorët me djegie të brendshme
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> prodhojnë energjinë që vë në lëvizje automjetin kthejnë energjinë termike të lëndës djegëse, në energji mekanike mund të jenë me dy ose me katër kohë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> shërbejnë për të prodhuar energji elektrike

	<ol style="list-style-type: none"> 2. janë vetëm me dy kohë 3. janë vetëm me dy cilindra
--	--

Pyetësori 305	Motori me djegie të brendshme, ka në përbërje të tij
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. mekanizmin bjellë-manivellë 2. sistemin e shpërndarjes, i cili komandon valvolat e motorit 3. sistemin e vaisjes 4. sistemin e ftohjes
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. friksionin 2. mekanizmat e transmetimit të lëvizjes 3. vetëm sistemin e ushqimit 4. kutinë e shpejtësisë

Pyetësori 306	Në motorin diesel, cikli i punës i të cilit realizohet në katër kohë,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. gjatë thithjes në cilindër hyn ajër i pastër nga valvola e thithjes 2. lënda djegëse sprucohet me presion në dhomën e djegies dhe vetëndizet 3. gjatë shtypjes ngjeshët vetëm ajër
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. katër kohët kryhen në një rrotullim të boshtit motorik dhe 2 rrotullime të boshtit të shpërndarjes 2. gjatë shtypjes bëhet djegia e lëndës djegëse 3. gjatë thithjes në cilindër hyn përzierje djegëse nga valvola e thithjes

Pyetësori 307	Mekanizmi bjellë-manivelë, në motorët me djegie të brendshme
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërben për kthimin e lëvizjes drejtvizore vajtje-ardhje të pistonit, në lëvizje rrotulluese të boshtit motorik 2. përbëhet nga bjella dhe boshti motorik 3. e merr lëvizjen nga pistoni
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. e merr lëvizjen nga boshti motorik 2. ka në përbërje dhe dinamion 3. ka në përbërje boshtin me gunga

Pyetësori 308	Korsa e pistonit është
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. rruga që bën pistoni nga pika e poshtme e vdekjes, deri te pika e sipërme e vdekjes 2. e barabartë me dyfishin e rrezes së manivelës 3. më e vogël në motorët me xhiro të mëdha
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. sa diametri i brendshëm i cilindrit 2. më e vogël në motorët me xhiro të ulëta 3. e barabartë me rrezen e manivelës

Pyetësori 309	Pistoni në motorët me djegie të brendshme,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. lidhet me bjellën me anë të spinotit 2. ka të montuara në të fashot e kompresionit dhe fashot e vajit 3. përbëhet edhe nga pjesa udhëzuese
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. montohet në testate 2. lidhet me kollodokun 3. është i palëvizshëm

Pyetësori 310	Fashot e kompresionit në motor,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. pengojnë gazrat mbi piston që të dalin në sotokarter (nënkarter) 2. transmetojnë edhe nxehtësi nga pistoni në muret e cilindrit 3. montohen në kokën e pistonit, mbi syrin e tij
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. montohen në cilindër 2. kur konsumohen rritet fuqia e motorit 3. shërbejnë për të realizuar rrëshqitjen e pistonit në cilindër

Pyetësori 311	Fashot e vajit në motor,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. pengojnë kalimin e vajit në dhomën e djegies 2. shpërndajnë njëtrajtësisht cipën e vajit në muret e cilindrit 3. vendosen në piston ,poshtë fashove të kompresionit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. janë të vendosur në piston, mbi fashot e kompresionit 2. janë me material alumini, që të digjen sa më shpejtë 3. shërbejnë për të penguar kalimin e gazeve në nënkarter

Pyetësori 312	Bjella në motorin me djegie të brendshme,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërben për kthimin e lëvizjes drejtvizore të pistonit, në lëvizje rrotulluese të boshtit motorik 2. lidhet me kollodokun, në qafën e tij me bronzina 3. lidhet me pistonin nëpërmjet spinotit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërben për lidhjen e boshtit motorik me boshtin e shpërndarjes 2. lidhet me boshtin me gunga nëpërmjet spinotit 3. nuk laget nga vaji i motorit

Pyetësori 313	Boshti motorik në motorët me djegie të brendshme,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. e merr lëvizjen nga bjella 2. ka qafat e bangove që mbështeten me kushineta rrëshqitëse (me bronzina), në bllokun e cilindrave 3. ka kundërpesha
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. përbëhet nga qafat e bjellave me të cilat mbështetet në bllokun e cilindrave 2. shërben për hapjen dhe mbylljen e valvolave 3. montohet në kokën e motorit (në testatë)

Pyetësori 314	Koka e motorit (testata)
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. mbyll dhomën e djegies nga ana e sipërme 2. në brendësi ka kanale për qarkullimin e vajit dhe të lëngut ftohës 3. mund të përmbajë dhe boshtin e shpërndarjes
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. vendoset në pjesën e poshtme të bllokut të cilindrave 2. në brendësi ka vetëm kanale për të qarkulluar vaj 3. në brendësi ka vetëm kanale për të qarkulluar ujë

Pyetësori 315	Nënkarteri (sotokarteri)
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërben për mbylljen e bllokut të cilindrave nga poshtë dhe si depozitë e vajit të motorit 2. montohet në bllokun e cilindrave 3. është pjesa më e poshtme e motorit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është pjesa më e sipërme e motorit 2. shërben edhe si depozitë e vajit hidraulik të grupit të timonit 3. montohet në testatë

Pyetësori 316	Sistemi i shpërndarjes së gazeve,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. realizon futjen e ajrit në cilindrat e motorit, sipas ciklit të punës të çdo cilindri 2. realizon nxjerrjen jashtë të gazrave të djegura në cilindrat e motorit 3. ka në përbërje të tij boshtin me gunga që komandon valvolat e motorit 4. ka në përbërje distribucionin, që mund të jetë me ingranazhe, i cili bën lidhjen e boshtit motorik me boshtin me gunga që komandon valvolat e motorit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërben për dhënien e lëvizjes diferencialit 2. përbëhet nga boshti kardanik 3. përbëhet nga xhuntot kardanike 4. e merr lëvizjen nga friksioni

Pyetësori 317	Boshti me gunga, në sistemin e shpërndarjes
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. komandon valvolat e motorit, për të hapur dhomat e djegies së motorit 2. përbëhet nga qafat mbështetëse dhe gungat 3. mund të montohet në testatë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. vë në lëvizje boshtin motorik 2. merr lëvizjen nga kutia e shpejtësisë 3. montohet në nënkarter (sotokarter)

Pyetësori 318	Në motorat me djegie të brendshme, valvolat
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. janë të thithjes dhe të shkarkimit 2. realizojnë mbyllje hermetike nga puthitja e tyre me brezin konik (me

	sedjen) 3. mbyllin dhomat e djegies nga veprimi i sustave të montuara te bishti i tyre
Përgjigje të gabuara	1. e thithjes janë më të vogla se ato të shkarkimit 2. hapen dhe mbyllin nga veprimi i sustave të montuara te boshti me gunga 3. hapen dhe mbyllin nga sustat e valvolave

Pyetësoni 319	Lidhja e boshtit të shpërndarjes së gazrave me boshtin motorik,
Përgjigje të sakta	1. për motorat e mëdhenj bëhet nëpërmjet rrotash të dhëmbëzuar 2. duhet të realizojë vënien në fazë të motorit 3. bëhet nga specialistë përkatës të motorëve (motoristi)
Përgjigje të gabuara	1. në të gjitha rastet, bëhet vetëm me rrip të dhëmbëzuar ose me zinxhir 2. mund të bëhet edhe me rrip trapezoidal 3. jo e mirë, nuk ndikon në punën e motorit

Pyetësoni 320	Dalja nga faza e boshtit të shpërndarjes së gazrave, mund të shkaktojë
Përgjigje të sakta	1. ndezje fillestare me vështirësi dhe rënie të fuqisë së motorit 2. shtrembërimin e ndonjë valvole motori 3. deformim të pistonit, bjellës apo testatës
Përgjigje të gabuara	1. gjithmonë vetëm fikje të motorit pa shkaktuar tjetër problem 2. prishjen e pompës së vajit 3. deformim të nënkarterit

Pyetësoni 321	Dalja nga faza e boshtit të shpërndarjes së gazrave, mund të shkaktohet nga
Përgjigje të sakta	1. këputja e dhëmbëve të rrotës së dhëmbëzuar, të vetë boshtit të vënies në fazë 2. këputja e dhëmbëve të ingranazheve që lidhin boshtin motorik me boshtin e shpërndarjes 3. këputja e dhëmbëve të ingranazheve, rripit të dhëmbëzuar ose zinxhirit të vënies në fazë
Përgjigje të gabuara	1. nga këputja e rripit trapezoidal 2. nga mosndërrimi i rripit të pompës së ujit 3. nga mosvajtësia e rripit të dhëmbëzuar

Pyetësoni 322	Mosregjistrimi i mirë i valvolave të motorit, mund të sjellë
Përgjigje të sakta	1. rritje të zhurmave të motorit 2. nxehje të motorit, më tepër se zakonisht 3. zvogëlim të presionit të përzierjes djegëse në fund të shtypjes
Përgjigje të gabuara	1. rritje të fuqisë së motorit

	<ol style="list-style-type: none"> 2. rritje të presionit të përzierjes djegëse në fund të shtypjes 3. rritje të sasisë së përzierjes djegëse në cilindër
Pyetësoni 323	Sistemi i ftohjes së motorëve me djegie të brendshme,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërben për të siguruar temperaturën optimale gjatë punës së motorit 2. realizon ftohjen e motorit me anë të ajrit dhe qarkullimit të detyruar të lëngut ftohës 3. mund të realizojë ftohjen e motorit vetëm me anë të ajrit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është gjithmonë vetëm me anë të ajrit 2. realizon ftohjen e motorit vetëm me anë të qarkullimit të vajit 3. shërben vetëm për ftohjen e bllokut të cindrave

Pyetësoni 324	Është pjesë e sistemit të ftohjes së motorëve me djegie të brendshme
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. pompa e lëngut ftohës 2. ventilatori i motorit 3. radiator 4. termostati 5. valvola avull ajër
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. pompa e vajit 2. boshti i shpërndarjes 3. kompresori i ajrit

Pyetësoni 325	Në sistemin e ftohjes së motorëve me djegie të brendshme,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. ventilatori realizon ftohjen e radiatorit me anë të lëvizjes së detyruar të ajrit 2. kapaku i radiatorit nxjerr avuj jashtë, kur është rritur shumë presioni i lëngut ftohës 3. kapaku i radiatorit bën që të hyjë ajër në radiator, kur është krijuar vakum për shkak të ftohjes së lëngut
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. përdorimi i ujit të zakonshëm, nuk e dëmton radiatorin 2. pompa e lëngut ftohës dërgon lëngun me presion në radiator 3. rekomandohet përdorimi i ujit natyral të zakonshëm

Pyetësoni 326	Termostati në sistemin e ftohjes,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërben për të rregulluar sasinë e lëngut ftohës që kalon për ftohje në radiator 2. ndalon kalimin e lëngut ftohës në radiator, kur motori është i ftohtë 3. kur nuk funksionon motori nxehet në mënyrë të menjëhershme
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. lejon lëngun ftohës të kalojë në radiator, kur motori është i ftohtë 2. vendoset përpara pompës së lëngut ftohës 3. duhet të zëvendësohet sipas stinëve

Pyetësori 327	Antifriza që ndodhet në lëngun ftohës,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. parandalon ngrirjen e lëngut ftohës në motor në kohë ngricash 2. rrit temperaturën e vlimit të lëngut ftohës 3. duhet të zëvendësohet pas një periudhe kohe
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. përdoret vetëm në kohën e dimrit 2. nuk zëvendësohet në asnjë rast 3. rrit temperaturën e ngrirjes së tij

Pyetësori 328	Kur gjatë lëvizjes me mjet, temperatura e motorit po tenton të rritet mbi atë të lejuar, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. që pasi të ndalojmë mjetin dhe fikim motorin, të presim sa të ftohet pak dhe pastaj të hapet me kujdes kapaku e të shtohet lëng ftohës, nëse ka nevojë 2. të ndalojmë mjetin dhe nëse nuk jemi në gjendje ta riparojmë vet defektin, të marrim masa për dërgimin e tij në servis 3. të kontrollojmë, nëse në motor mungon sasia e nevojshme e lëngut ftohës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të vazhdojmë lëvizjen normalisht me mjetin deri sa të gjejmë servisin 2. fillimisht të verifikojmë cilësinë e karburantit 3. të kontrollojmë siguresat

Pyetësori 329	Nëse temperatura e motorit rritet mbi kufijtë e lejuar, shkak mund të jetë
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. këputja apo rrëshqitja e rripit që vë në lëvizje pompën e lëngut ftohës 2. bllokimi me papastërti i kanaleve të radiatorit 3. rrjedhja e lëngut ftohës nga pjesë të sistemit të ftohjes 4. defektimi i pompës së lëngut ftohës 5. dëmtimi i fletëve të radiatorit dhe mbushja me papastërti e hapësirave të tij
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. mosfunksionimi i kompresorit të kondicionerit 2. rrjedhja e vajit nga kutia e shpejtësisë 3. sasia e tepërt e lëngut ftohës 4. përdorimi i marsheve ndërmjetëse 5. përdorimi i tepërt i antingrirsit në lëngun ftohës

Pyetësori 330	Konsumimi i lëngut ftohës në motor, mund të ndodh nga
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. çarja e radiatorit ose e tubacioneve të gomës në të cilën qarkullon lëngu ftohës 2. plasaritja e testatës apo nga dëmtimi i guarnicionit të testatës 3. prishja e kapakut të radiatorit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. çarja e kolektorit të shkarkimit të gazrave

	<ol style="list-style-type: none"> 2. defektimi i pompës së vajit 3. rritja e shpejtësisë së lëvizjes mjetit
--	--

Pyetësoni 331	Sistemi i vajisjes në motorët me djegie të brendshme,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërben për të dërguar vajin lubrifikues në pjesët e lëvizshme të motorit 2. mund të jetë i kombinuar, duke e dërguar vajin me presion dhe me spërkatje 3. zvogëlon fërkimin, largon nxehtësinë dhe mbeturinat midis pjesëve të lëvizshme të motorit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është vetëm me spërkatje 2. shërben edhe për vajsjen e kutisë së shpejtësisë 3. shërben vetëm për ftohjen e motorit

Pyetësoni 332	Është pjesë përbërëse e sistemit të vajsjes së detyruar të motorëve me djegie të brendshme:
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. pompa e vajit 2. filtri i vajit 3. valvola e sigurisë për qarkullimin e vajit, në rast bllokimi të filtrit të vajit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. pompa hidraulike e grupit të timonit 2. pompa e lëngut ftohës 3. turbokompresori

Pyetësoni 333	Pompa e vajit në motorët me djegie të brendshme,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. dërgon vajin me presion në qafat e bangove e bjellave të boshtit motorik 2. e merr lëvizjen nga boshti motorik 3. mund të vihet në lëvizje me një nga ingranazhet e distribucionit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. dërgon vajin me presion, vetëm në qafat e boshtit të shpërndarjes 2. vihet në lëvizje nga rripi i dinamos 3. vihet në lëvizje direkt nga volanti i motorit

Pyetësoni 334	Vaji lubrifikues i motorëve,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. duhet të ketë temperaturë ngrirje të ulët 2. duhet të ketë viskozitetin e nevojshëm edhe gjatë punës 3. përcaktohet nga konstruktori (ndërtuesi), në varësi të llojit të motorit 4. përdoret edhe në varësi të stinës
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 3. duhet të ketë përmbajtje uji 1. duhet të jetë i njëjte si në periudhën e dimrit, ashtu edhe në periudhat e nxehta 2. duhet të ketë temperature flakërimi (ndezje) të ulët 3. duhet të ndërrohet sa më shpesh edhe pse gjendja e tij mund të jetë e

	mirë
Pyetësori 335	Vajisja e motorëve me djegie të brendshme
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. për një pjesë detalesh, realizohet me dërgim të detyruar të vajit me anë të pompës së vajit 2. për një pjesë detalesh, mund të bëhet me dërgim të vajit me spërkatje 3. ndikon në jetëgjatësinë e motorit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk është e detyruar për të gjitha llojet e motorëve me djegie të brendshme 2. realizohet në të gjitha rastet, vetëm me anë të spërkatjes nga rrotullimi i mekanizmit bjellë-manivelë 3. nuk ndikon në jetëgjatësinë e motorit
Pyetësori 336	Rënia e presionit të vajit, mund të shkaktohet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. nga bllokimi i pompës së vajit të motorit 2. nga prishja e bronzinave të ndonjë bjelle 3. nga mungesa e vajit në sotokarter, si rezultat i ndonjë çarje të tij 4. nga zvogëlimi i viskozitetit, si rezultat i mbinxehjes së motorit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nga hedhja e vajit mbi nivelin e duhur 2. nga bllokimi i pompës hidraulike të timonit 3. nga bllokimi i pompës së naftës 4. nga këputja e rripit të pompës së lëngut ftohës
Pyetësori 337	Kur gjatë lëvizjes konstatojmë se presioni i vajit (që tregohet në manometer) po shkon drejt zeros, duhet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. të kontrollojmë se mos ka çarje të nënkarterit dhe rrjedhje të vajit lubrifikues 2. që pas fikjes së motorit të verifikojmë nivelin e vajit në motor 3. të ndalojmë mjetin në rastin më të shpejtë të mundur dhe të fikim motorin
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. të rrisim shpejtësinë për të arritur sa më shpejt në servis 2. të shtojmë vaj megjithëse ai është në nivelin e duhur 3. të mos shqetësohemi sepse nuk përbën rrezik për motorin
Pyetësori 338	Ndërrimi i vajit të motorit,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. varet nga cilësia e vajit, kilometrat e përshkuara dhe kushtet e rrugës së kryer nga mjeti 2. pas riparimit të motorit duhet të bëhet më shpejt se zakonisht 3. bëhet duke ndërruar edhe filtrin e vajit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. varet nga koha e qëndrimit të tij në motor edhe pse mund të mos ketë punuar 2. bëhet sa herë konstatojmë rënie të presionit të tij

	3. varet edhe nga lloji i kutisë së shpejtësisë (kambios) së automjetit
--	---

Pyetësoni 339	Konsumimi i vajit në motor, mund të
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. ndodhë nga konsumimi i fashove dhe cilindrave të motorit 2. vijë edhe nga konsumimi i turbokompresorit 3. vijë edhe nga thyerja e fashove të vajit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. shkaktohet nga që sasia e vajit është mbi nivelin e lejuar 2. vijë nga djegia e bronzinave të bjellës 3. shkaktohet nga bllokimi i filtrit të vajit

IX.2 Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes

Pyetësoni 340	Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 4. transmetojnë lëvizjen nga motori te rrotat aktive 5. përbëhen nga friksioni, kutia e shpejtësisë, transmisioni, diferenciali, etj. 6. realizojnë edhe zvogëlimin e ngarkesave përdredhëse dinamike që transmetohen për në motor
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 4. shërbejnë vetëm për transmetimin e lëvizjes nga kutia e shpejtësisë, te rrotat aktive 5. përbëhen vetëm nga semiakset 6. janë pjesë të motorit

Pyetësoni 341	Është pjesë e mekanizmave të transmetimit të lëvizjes
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 5. friksioni 6. kutia e shpejtësisë (kambio) 7. transmisioni kardanic me xhuntut kardanike 8. diferenciali së bashku me gjysmëakset (semiakset)
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 4. boshti motorik 5. stabilizatorët me balestrat e mjeti 6. boshti me gunga

Pyetësoni 342	Friksioni
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. realizon transmetimin dhe shkëputjen e lëvizjes, nga boshti motorik në boshtin primar të kutisë së shpejtësisë 2. mund të jetë mekanik ose hidraulik 3. kur është mekanik, komandohet nga drejtuesi i mjetit nëpërmjet pedalit 4. bën të mundur nisjen e qetë të mjetit nga vendi 5. mbron motorin dhe mekanizmat e tjerë të lëvizjes, nga mbingarkesat dinamike
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. hidraulik (automatik) komandohet me pedal 2. është mirë të shtypet shpesh, për të zvogëluar distancën e sigurisë me mjetin para

	<ol style="list-style-type: none"> 3. është pjesë e motorit 4. transmeton lëvizjen nga kutia e shpejtësisë në diferencial
--	---

Pyetësori 343	Friksioni mekanik
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. ndihmon drejtuesin e mjetit, për të realizuar ndërrimin e marsheve 2. ka diskun me ferrota që montohet në boshtin primar, të kutisë së shpejtësisë nëpërmjet shlicave 3. ka disk shtrëngues (spinxhidisku) që shtyn diskun me ferrota te volanti i motorit 4. mund të ketë sistem komandimi të tipit mekanik, hidraulik apo pneumatik 5. shërben edhe për zbutjen e ngarkesave dinamike që lindin gjatë lëvizjes së mjetit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. realizon transmetimin e lëvizjes nëpërmjet vajit që ka 2. përbëhet vetëm nga disku i friksionit me ferrota 3. merr lëvizjen nga kutia e shpejtësisë (kambio) 4. shërben për ndezjen e motorit

Pyetësori 344	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shkëput transmetimin e fuqisë motorike, për në rrotat aktive të mjetit 2. shkakton ndarjen e diskut (apo disqeve) me ferrota nga volanti i motorit 3. realizohet nga drejtuesi i mjetit me këmbën e majtë 4. e mbajtur për një kohë të gjatë, dëmton kushinetën e friksionit 5. përdoret edhe për ta bërë më të lehtë ndërrimin e marsheve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. realizon transmetimin e fuqisë motorike në rrotat drejtuese të mjetit 2. gjatë lëvizjes së mjetit, sjell ndaljen e menjëhershme të tij 3. shkakton bashkimin e disqeve të friksionit 4. shërben për transmetimin e lëvizjes

Pyetësori 345	Friksioni mekanik
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. mund të jetë me një ose disa disqe 2. përbëhet nga disku (apo disqet) me ferrota dhe disku shtrëngues (spinxhidisku) 3. përdoret dhe në kamionë të rëndë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është pjesë e motorit 2. përbëhet nga disku i friksionit, i cili e merr lëvizjen nga kutia e shpejtësisë 3. punon në ambient vaji

Pyetësori 346	Friksioni hidraulik
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është pjesë e mekanizmave të transmetimit të lëvizjes 2. transmeton xhirot e boshtit motorik, në boshtin e parë të kutisë së shpejtësisë (kambios) 3. përbëhet nga pjesa aktive (pompa) dhe ajo pasive (turbina) 4. punon me vaj hidraulik, i cili duhet të ndërrohet periodikisht
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është pjesë e motorit 2. punon me vajin e motorit 3. nuk është pjesë e mekanizmave të transmetimit të fuqisë

Pyetësori 347	Kutia e shpejtësisë me ingranazhe (kambio manuale)
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërben për të ndryshuar shpejtësinë e lëvizjes së mjetit, sipas kushteve rrugore e të qarkullimit dhe për lëvizje të mjetit prapa 2. me levën e marsheve në pozicion afolje (neutral), kur motori është i ndezur, shkëput xhirot për në transmision 3. merr lëvizjen nga friksioni dhe ja jep transmisionit kardanik
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. ja jep lëvizjen friksionit 2. shërben vetëm për të ndryshuar shpejtësinë e lëvizjes 3. mund të ndërrohet pa problem, me një kambio të një tipi tjetër

Pyetësori 348	Kutia e shpejtësisë automatike (kambio automatike),
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. përbëhet nga mekanizma që realizojnë ndryshim të pashkallëzuar, të momentit përdredhës 2. ka boshtin primar që është i lidhur me turbinën e friksionit hidraulik 3. realizon nisje të shpejtë të mjetit nga vendi
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk ka nevojë për vaisje 2. komandohet me pedal me këmbën e majtë 3. realizon ndërrimin e marsheve vetëm me xhunto me dhëmbë

Pyetësori 349	Mjetet me kalueshmëri të lartë (me ridoto)
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. përveç kutisë së shpejtësisë kanë edhe kuti shpërndarëse ose kuti shpejtësie suplementare (ridoto) 2. kanë më shumë se një diferencial 3. kanë kuti shpejtësie suplementare (ridoto) që merr lëvizjen nga kutia e shpejtësisë dhe ja jep transmisioneve kardanik 4. kanë kuti shpejtësie suplementare (ridoto) që përdoret në kushte të vështira rrugore 5. kanë kuti shpejtësie suplementare (ridoto) që u jep lëvizje njëkohësisht dy transmisioneve të mjetit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. kanë ridoto që shërben për të ndryshuar fuqinë e motorit 2. kanë kuti shpejtësie suplementare (ridoto) që e merr lëvizjen direkt nga friksioni 3. kanë kuti shpejtësie suplementare (ridoto) që vendoset para kutisë së

	shpejtësisë 4. kanë kuti shpejtësie suplementare (ridoto) që zëvendëson kutinë e shpejtësisë
--	---

Pyetësoni 350	Kutia e shpejtësisë me ingranazhe (kambio manuale), ka në përbërje
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. boshtin primar që e merr lëvizjen nga friksioni 2. boshtin sekondar që ja jep lëvizjen transmisionit kardanik 3. sinkronizatorë, të cilët në rast ndërrimi të marshit, përshtatin shpejtësitë rrotulluese të ingranazheve, për të realizuar ingranime të tyre pa kërcitje 4. levën e marsheve që komandon fuqëcellat, për lëvizjen e ingranazheve 5. boshtin e marshit të lëvizjes prapa
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. disk me ferota që vendoset në boshtin e parë 2. boshtin ndërmjetës që ja jep lëvizjen transmisionit 3. boshtin primar që ja jep lëvizjen transmisionit 4. sinkronizatorë që marrin lëvizjen nga friksioni

Pyetësoni 351	Transmisioni kardanik
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. transmeton lëvizjen nga kutia e shpejtësisë, te çifti pinjon-koronë i diferencialit 2. transmeton lëvizjen në kënde dhe distancë të ndryshueshme, gjatë lëvizjes së mjetit 3. ka boshtin kardanik, i cili lidhet me pinjonin nëpërmjet shlicave 4. në mjetet e gjata, mund të përbëhet nga dy boshte
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. duhet të jetë sa më i rëndë që të transmetojë mirë lëvizjen 2. ka si pjesë përbërëse dhe ridoton 3. ja jep lëvizjen kutisë së shpejtësisë

Pyetësoni 352	Transmisioni kryesor (çifti pinjon-koronë)
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërben për ti dhënë lëvizjen diferencialit nga transmisioni kardanik 2. ka në përbërje pinjonin, i cili e merr lëvizjen nga transmisioni kardanik 3. ka në përbërje koronën që lidhet me kutinë e diferencialit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. merr lëvizjen nga diferenciali dhe ja jep semiakseve 2. shërben për të rritur ose për të zvogëluar shpejtësinë e lëvizjes së mjetit në rrugë 3. është pjesë e boshtit motorik

Pyetësoni 353	Regjistrimi i transmesioni kryesor (çiftit pinjon-koronë)
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. realizon takim më të madh midis dhëmbëve të pinjonit me atë të koronës 2. bëhet nëpërmjet regjistrimit të kushinetave konike të pinjonit 3. bëhet në servise të specializuara
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. kërkon regjistrimin e vetëm të njëres kushinetë 2. realizohet nga drejtuesi i mjetit, gjatë lëvizjes së mjetit 3. nuk bëhet në asnjë rast, por vetëm ndërrohet çifti pinjon-koronë

Pyetësoni 354	Diferenciali
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. ndryshon xhirot në rrotat aktive, gjatë lëvizjes së mjetit në kthesa 2. transmeton lëvizjen në rrota me anë të semiakseve 3. punon në ambient vaji 4. ka planetarët, të cilët lidhen me semiakset nëpërmjet shlicave 5. ka satelitët, të cilët janë të ingranuar me planetarët dhe që kryejnë rrotullime rreth aksit të tyre, kur mjete lëviz në kthesa 6. e merr lëvizjen nga çifti pinjon-koronë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. e merr lëvizjen nga semiakset 2. mund të jetë me një ose dy planetarë 3. shërben për ndryshimin e shpejtësisë së lëvizjes së mjetit

Pyetësoni 355	Blokazhi i diferencialis
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. përdoret në rast xhirimi të njëres prej rrotave aktive, në baltë apo akull 2. kur vihet në punë realizon lidhjen e dy semiakseve 3. i vënë në funksionim bllokun rrotullimin e satelitëve, rreth aksit të tyre
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. përdoret në lëvizje normale me mjet dhe në rrugë të asfaltuar me kthesa 2. i vënë në funksionim bllokun rrotullimin e planetarëve dhe semiakseve 3. përdoret në të gjitha automjetet

Pyetësoni 356	Nëse pas shtypjes së pedalit të friksionit ai nuk arrin të bëjë shkëputjen e xhirove (nuk ndan),
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. kjo mund të vijë se është defektuar sistemi i komandimit të friksionit 2. futja e marsheve bëhet me vështirësi 3. mjete duhet të dërgohet në servis, për të eliminuar defektin
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. mund të jenë konsumuar ferrotat 2. mund të ketë defekt kutia e shpejtësisë 3. mund të jenë lagur ferrotat e friksionit me vaj

Pyetësori 357	Vështirësia në ndërrimin e marsheve, mund të shkaktohet nga
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> defektimi i kushinetës së friksionit regjistrimi i keq i sistemit të komandimit të friksionit (ka rrugë boshe të pedalit) shtrembërimi i diskut të friksionit konsumimi i furçellave ose sinkronizatorëve të kutisë së shpejtësisë konsumimi i bokollave të levave të komandimit, të furçellave të kutisë së shpejtësisë
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> konsumimi i ferrotave të diskut të friksionit mbinxehja e ferrotave të diskut të friksionit rënia e vajit në ferrotat e friksionit prania e vajit në kutinë e shpejtësisë

Pyetësori 358	Mostransmetimi i plotë i lëvizjes nga friksioni, mund të shkaktohet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> nga konsumimi i ferrotave të diskut të friksionit, nga përdorimi i shpeshtë i tij nga rënia e vajit në ferrotat e diskut të friksionit nga mbinxehja e ferrotave (djegia e ferrotave të friksionit)
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> nga vendosja e një disk friksioni me ferrota më të trasha nga defektimi i kushinetës së friksionit nga prishja e levës së marsheve

Pyetësori 359	Mosfunksionimi i mirë dhe defektimi i kutisë së shpejtësisë, mund të shkaktohet nga
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> mungesa e vajit që sjell konsumim të kushinetave, ingranazheve etj. mosfunksionimi i mirë i friksionit përdorimi i forcës gjatë futjes së marsheve, jo në kohën e duhur konsumimi i elementëve të sistemit të komandimit të furçellave të saj
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> mosfunksionimi i rregullt i diferencialit përdorimi i gjatë i marsheve, pa i ndërruar rrjedhja e vajit të tepërt

Pyetësori 360	Defektimi i diferencialit, mund të shkaktohet nga
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> mungesa e vajit, si rezultat i prishjes së permistopave mos regjistrimi i mirë i kushinetave, me të cilat mbështetet tek ura dëmtimi i dhëmbëve të planetarëve dhe satelitëve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> fryrja e gomave mbi normat e lejuara rrjedhja e vajit që është mbi nivel prishja e transmisionit kardanik

Pyetëtori 361	Ndërprerja e lëvizjes në rrotat aktive, mund të shkaktohet
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> nga konsumimi i diskut të friksionit, jashtë kufijve të lejuar nga mosingranimi i ingranazheve në kutinë e shpejtësisë nga prishja e xhuntos kardanike nga këputja e një semiaksi apo planetari
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> nga prishja e kushinetës së friksionit nga prishja e mekanizmit të komandimit të friksionit nga rënia e nivelit të vajit në kutinë e shpejtësisë

IX.3 Shasia, karrocëria, mekanizmi i drejtimit, i lëvizjes, i frenimit, gomat dhe suspensionet, llojet, ndërtimi,

Pyetëtori 362	Shasia është elementi bazë i mjetit
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> në të cilën është shënuar numri i identifikimit të mjetit që shërben për mbajtjen e kabinës, karrocërisë, motorit, etj. që nuk lejohet të ndërrohet me shasi tjetër, gjatë gjithë kohës së përdorimit të mjetit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> që shërben për lidhjen e motorit me diferencialin që mund të zëvendësohet me një tjetër, në rast se dëmtohet që shërben vetëm për mbajtjen e ridotos, për mjetet me dy ura aktive

Pyetëtori 363	Shasia e mjetit
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> është prej material çeliku në rast se deformohet, ndikon negativisht në lëvizjen e mjetit është pjesa e pandryshueshme e një mjeti rrugor lidhet me urat nëpërmjet suspencioneve, amortizatorëve dhe stabilizatorëve
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> duhet të jetë një konstrukcion (ndërtim) plastik lejohet të ndërrohet, kur nuk mund të riparohet mund të ndërrohet në rast dëmtimi lidhet me urat e mjetit vetëm në mënyrë të ngurtë që të bëhet një copëshe me ta në të gjitha automjetet është një copëshe si ajo e autoveturave

Pyetëtori 364	Në urën e parë të automjetit
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> të pajisur me diferencial, janë të montuar grushtet e kthimit ose çernierat kardanike të rrotave drejtuese janë të montuar suspencionet (balestra, susta apo jastëk ajri) që nuk ka diferencial, janë të montuar spinotat e muzove të rrotave drejtuese
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> të gjithë automjetet kanë diferencial gjithmonë janë vendosur rrota aktive rrotat drejtuese nuk mund të jenë njëkohësisht dhe aktive

Pyetësoni 365	Konvergjencia e rregullt e rrotave drejtuese
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë (stabilitetin) e mjetit gjatë lëvizjes së tij 2. verifikohet në servise të specializuar, mbi bazën e këndeve të konvergjencës të përcaktuar nga konstruktori (ndërtuesi) për mjetin e dhënë 3. përcaktohet nga pozicioni reciprok midis aksit të kthimit të rrotës me planin vertikal ,i cili duhet të jetë sipas të dhënave të konstruktorit (ndërtuesit) të mjetit
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. e bën të vështirë manovrimin e mjetit në kthesë 2. nëse ura deformohet nuk prishet 3. përcaktohet nga këndi i ndërprerjes se planeve të rrotave drejtuese, i cili është i njëjtë për të gjitha llojet e mjeteve

Pyetësoni 366	Ndryshimi i pozicionit të aksit të kthimit të rrotës
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. mund të ndodhë gjatë përplasjes së mjetit me objekte të tjera 2. mund të shkaktohet, kur zëvendësohen pjesë në sistemin e drejtimit të mjetit 3. mund të keqësojë rikthimin e rrotave të mjetit në pozicionin e drejtë, pas një kthese
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. nuk ndikon në manovrimin e mjetit në rrugë me kthesa 2. ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e mjetit gjatë lëvizjes në rrugë të drejtë 3. ndikon pozitivisht në rikthimin e rrotave, në pozicionin e drejtë

Pyetësoni 367	Ura e dytë e një automjeti
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. lidhet me shasinë nëpërmjet suspensioneve (balestra apo jastëk ajri) 2. në skaje ka mocot e rrotave që montohen me të nëpërmjet kushinetave 3. ka distancë të caktuar nga ura e parë, e vendosur nga konstruktori (ndërtuesi)
Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. lëkundjet e veta ja transmeton shasisë 2. nuk lejohet të ndërrohet 3. në rast deformimi, nuk ndikon në qëndrueshmërinë e mjetit në lëvizje

Pyetësoni 368	Në urën e dytë të një automjeti që ka rrota aktive,
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. është diferenciali së bashku me transmisionin kryesor (çiftin pinjon-koronë) 2. ka semiakse që transmetojnë lëvizjen nga diferenciali në rrota 3. ka një tapë për kontrollin e nivelit të vajit në diferencial

Përgjigje të gabuara	<ol style="list-style-type: none"> 1. është vendosur kutia e shpejtësisë dhe friksioni 2. ndodhen xhuntut kardanike 3. është vendosur transmisioni kardanik 4. ndodhet edhe friksioni
----------------------	---

Pyetësoni 369	Balestrat e automjetit
Përgjigje të sakta	<ol style="list-style-type: none"> 1. shërbejnë për lidhjen elastike të shasisë me urat 2. lidhen me urat nëpërmjet kavallotave, ndërsa me shasinë nëpërmjet piskutinave 3. nuk lejojnë që ngarkesat goditëse të urave të transmetohen shasisë
